

LEXMARK
LEGAL

PO MENDONI TË EMIGRONI NË MB DHE JU
DUHEN KËSHILLA TË SIGURTA LIGJORE?

JENI NË VENDIN E DUHUR!

Ekipi ynë i avokatëve të specializuar në emigracion ofron
asistencë profesionale për:

- Aplikime për viza
- Çështje azili
- Vendbanim të përhershëm (ILR)
- Apeli kundër dëbimit
- Shtetësi britanike

Ne ju mbështesim me përkushtim dhe
transparencë në çdo fazë të procesit.

E ARDHMJA JUAJ NË MB FILLON ME
VENDIMIN E DUHUR.

Kontaktoni Lexmark Legal sot – ekspertët
që ju qëndrojnë pranë në çdo hap.
Partneri juaj i besueshëm në emigracion.



- 07494181220
- 07435119343
- 02080902488

Ashley House 235 - 239
High Road, Wood Green,
London N22 8HF


www.lexmarklegal.com

The Albanian

VITI I 23 I BOTIMIT 25 PRILL 2026

Tel: 020 7018 7929 30 Avenons Road London E13 8HT

**AMBASADORI BRITANIK:
GRUPI MË I MADH I TË DËNUARËVE
NË MBRETËRINË E BASHKUAR
JANË SHQIPTARË**



PETRIT KUÇANA

**TË DËNUARIT
SHQIPTARË NË BRITANI
SI MOMENT REFLEKTIMI
PËR SHOQËRINË
SHQIPTARE**



**AMBASADORI FERIZI
PËR THE GUARDIAN:
MJAFT I SHENJESTRUAT
PADREJTESISHT
SHQIPTARËT**

**JUGOSLLAVIA ISHTE
KRIJUAR ME QËLLIM
QË SERBËT TË ISHIN FITUES
TË PËRHERSHËM
DAUT DAUTI**



**PËR PUNËT E
SHQIPËRISË**

DITMIR BUSHATI



**BASHKËVEPRIMI KOLEKTIV,
SHQIPTARËT RACIONALË
EDHE MUNGESA E ELITËS
INTELEKTUALE!**

IRENA BEQIRAJ



**A KA MERITOKRACI
NË POLITIKËN
SHQIPTARE?**

ANDI MUSTAJ



**LIRIA
KA EMRA**

VETON SURROI



Rashid A.Khan Solicitor (Principal) Mob: 07774222062 190 MERTON HIGH STREET WIMBLEDON, LONDON SW19 1AX



RASHID & RASHID
Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths



The Albanian newspaper in London

THE ALBANIAN
www.thealbanian.co.uk

www.thealbanian.co.uk

albania7@gmail.com

Tel: 020 7018 7929



PETRIT KUÇANA

Më shumë se të trishtueshmë janë lajmet që thuajse nuk kanë fund për shqiptarët e Britanisë që kapen në fermat e kanabisit.

Janë ato foto dritëshuara shprese të këtyre të rinjëve, që u farkëtuan nga shoqëria shqiptare, me ëndrrën mashtruese britanike.

Janë pikërisht këta të rinj memoriali shpirtëror i shkërmoqjes së shoqërisë shqiptare, së paku i dekadës së fundit. Janë pikërisht këta të rinj momenti më sublim i reflektimit të shoqërisë shqiptare, edhe pse duket se është vërtet vonë, tmerrësisht vonë.

Nuk është thjesht ripërtëritja e tyre, pra numri i pandryshuar i të burgosurve shqiptarë në Britani, që nuk zbret nga 1000, por mosndalja e turrit drejt të mallkuarave burgjeve ishullore, drejt ëndrrës britanike me të cilën u mëkuan, herët... shumë herët dhe ja sot pas dekadash, gjenden dritëshuar përpara dënimit.

Janë fotot e pafundme të këtyre të rinjve, që publikohen nga autoritetet britanike, simboli i dështimit të shoqërisë shqiptare, i gjithësecilit prej nesh, secili me peshën e kryqit të vet.

Mozaiku i fotove të këtyre të rinjëve, duhet të kthehet në simbol të mos-harresës, mospërsëritjes dhe së paku ndërgjegjësimit.

Ndërgjegjësim për bjerrjen e vlerave, për shkatërrimin thuajse total të gjithçkasë për të cilën lufton gjithkush në botën e civilizuar.

Duhet të jetë mozaiku i këtyre fotove të të rinjve që të na rikujtojë 'heshtjen tonë si shoqëri', kur mbi një dekadë më parë pamë sesi filloi eksperimenti i kanabizimit të vendit dhe u hesht.

U hesht deri në dhimbje.

E pikërisht në këtë kohë mbase, këta të rinjë, që sot po kalben në burgjet britanike, panë sesi pasuroheshin fët e fët, të gjithë ata 'të lartit'.

E ç'kuptim kishte shkolla, bankat, çantat, librat, mësuesit, ku gjithçka



MOZAIKU I SHQIPTARËVE TË DËNUAR NË BRITANI SI MOMENT REFLEKTIMI PËR SHOQËRINË SHQIPTARE

mund të blihej e të shitej krejtësisht hapur nga policët e deri tek politikanët.

Helmi u ngjiz në gjakun e tyre, pa kuptuar se po fillonte shkatërrimi i rinisë së tyre.

E kushedi sa janë penduar tani, për atë modelin që ju servir, për të cilët ata, pra këta të rinj, kurrësesi nuk mund të jenë fajtorë, osë të gjithë mund të jenë fajtorë përveç këtyre.

E mbase në këtë kohë gjendet edhe zanafilla e pyetjeve se përse vetëm shqiptarët i janë 'vërsulur' kësaj pune. Si është e mundur që nuk ka asnjë shqiptar të Kosovës, të Maqedonisë, Malit të Zi etj etj... që janë të përfshirë në ëndrrën britanike?

Pse-në mbase e dijmë...

E kushedi edhe sa kohë do të vazhdojë kështu...

Por duhet që atë mozaik fotosh të rinjsh shqiptarë që kalben në burgjet britanike, të ngritet si përmendore e së keqes, e turpët.

Duhen riprodhuar me mijëra e mijëra kopje dhe tu dhurohen të gjithëve, papërgjigjet të gjithëve, që nga presidenti i republikës.

Po po edhe ai ta mbajë në zyrë përmendorën e shqiptarëve që kalben në burgjet britanike dhe jo vetëm...

Ta mbajë në zyrë kryeministri që është edhe përgjegjësi i drejtpërdrejtë për kanabizimin e Shqipërisë, e ta shikojë çdo ditë, cdo kohë si rezultat i politikave të tij, e të reflektojë qoftë edhe si njeri, si prind, si familjar e më pas edhe si politikan, si politikan i përgjegjës që pranoi këtë katastrofë si eksperiment në vendin e tij.

Patjetër që historia do të jetë e pamëshirshme...

Këtë mozaik duhet dhuruar çdo deputeti e ish-deputeti, çdo ligjvënës e ish-ligjvënës, gjithkush që është atje lart në majë të politikës që nuk bëri diçka më shumë, për të ndalur atë zezonë, që u mori jetën shumë e shumë të rinjve e që po vazhdon e vazhdon, si flama e kurrëmoskur prej trupit të njomë të të rinjve shqiptarë.

Është ajo zezonë që u ngjiz si ëndërr, kur nuk mbeti copë toke e atdheut pa u kanabizuar, sic u vërtetua edhe vetëm pak vite më vonë, ku ministra e drejtorë policie dolën se ishin kapot... ku ministra e deputetë ishin përfshirë në luftën e pandalshme të pasurimit... të pafre të pangopësisë... Gjithësecili prej tyre duhet ta ketë në tavolinën e punës e sa herë të miratoje ligje, të reflektojë thellë, si njeri e si politikan, e çdo ditë ta shikojë

mozaikun si lajtmotiv që nuk duhet heshtur, më sa paku...

Atë mozaik duhet ta ketë në tavolinën e punës çdo ministër. Secili prej tyre të reflektojë tek sodit në tmerrin e syve të shkrimur të këtyre të rinjëve që po kalben në burgjet britanike dhe më gjerë.

Atë mozaik duhet ta ketë cdo drejtor drejtorie, e deri tek çdo nënpunës i thjeshtë i shtetit shqiptar që të mendojë e reflektojë se shteti nuk është vendi ku mulet çdo ditë, mundësia për të vjedhur, grabitur, përfutur, por për tu shërbyer qoftë edhe të tjerëve që nuk kanë ikur akoma drejt ëndrrës britanike apo amerikano-latine...

Atë mozaik duhet patjetër ta marrë çdo patronazhist, që të reflektojë si qenie njerëzore, e të pendohet cdo ditë për çdo mëkat që mund të ketë bërë, me verprimin apo mosverprimin e tij, që të kuptojë se ky sekt i turpshëm ka shkatërruar cdo vlerë për të mbajtur në pushtet ata që po i marrin asaj Shqipërie çdo ditë nga pak... që i kanë marrë e po i marrin hisen atyre të rinjve, si dhe gjithkujt që i ra të lindë në atë vend të bekuar.

Po po atë mozaik duhet shumëfishuar dhe duhet shpërndarë gjithandej, deri tek pasanikët e atij vendi, që të reflektojnë në pangopsinë e tyre, për aq sa mund të reflektojnë.

Ai mozaik duhet ta ketë vendin në cdo redaksi lajmesh, televizione apo portale, tek cdo drejtor apo kryeredaktor që 'ka takat' të përcaktojë një politikë të ndershme editoriale, që i shërben interesit publik, tek cdo gazetar e reporter që e bën punën e vet me ndershmëri, deri në kushtet e përjashtimit nga puna. Ai mozaik duhet të jetë motiv për punën e tyre në shërbim të interesit publik...

Ai mozaik duhet ta ketë vendin në cdo bashki, në çdo njësi bashkiake, tek cdo nënpunës i shtetit shqiptar deri në skajet më të largëta, që të reflektojnë sesi duhet të ndryshojnë cdogjeja, që mozaikë të tilla të mos ketë më kurrë.

Ai mozaik duhet ta ketë vendin në cdo shkollë, akoma të pambyllur, në cdo drejtori, tek çdo mësues që dështoi në misionin e tij.

Po e gjithë ajo plejdë mësuesish u gjuhëzuan ashtu ngadalë duke u mësuar me të keqen që e shikonin tek nxënësit e tyre, pa mundur të qëndrojnë fort haptas, si misionarë të edukimit të brezit të ri. Si ata mësues dështuam të gjithë papërgjigjet... gjithësecili nga ne, në cdo fushë të jetës.

Ai mozaik duhet të jetë në çdo klasë që të shikohet cdo ditë nga gjimnazistët që tashmë janë të ushqyer me 'ëndrrën britanike' apo amerikano-latine, për të reflektuar sa nuk është vonë, se një ditë nëse vazhdojnë të ushqejnë atë ëndërr do të jenë në atë mozaik.

Ai mozaik duhet ta ketë vendin në cdo klasë që çdo nxënë të reflektojë cdo ditë sesi nuk duhet bërë, për t'iu rikthyer mësimi, se pasurimi i shpejtë është veçse ai mozaik me fytyrat e përhumbura të mijëra e mijëra të rinjve shqiptarë, që kalben nëpër burgjet e botës.

E mbase do të duhet të reflektojmë si shoqëri, sa nuk është tmererësisht vonë, për tu rikthyer tek vlerat evropiane, qoftë tek vlerat njerëzore.

E mbase kështu do të reflektohet deri në neveritjen e eksperimenteve në trupin e atdheut tonë, deri në neveritjen e modeleve të suksesit, 'që nuk bëjnë transport nën 100 kile'.

Pikërisht ai mozaik i të rinjëve që po kalben në burgjet e botës duhet të shërbejë si moment reflektimi, sa nuk është tmerrësisht vonë.

ribotim

**L E X M A R K
L E G A L**

DËSHIRONI TË JETONI, PUNONI APO STUDIONI NË MB?

Ne ofrojmë shërbime të specializuara imigrimi, të përshtatura sipas rrethanave tuaja.

Ekipi ynë profesionist ju udhëzon në çdo hap, duke e bërë procesin e imigrimit të qartë, të sigurt dhe pa stres.

SHËRBIMET TONA PËRFSHIJNË:

- Viza për punëtorë të kualifikuar
- Viza studimi
- Viza për bashkëshort dhe familjarë
- Viza Global Talent & Inovative
- Punonjës fetarë
- Vendbanim të përhershëm (ILR)
- Shtetësi britanike
- Apeline dhe rishikime vizash

Ne ju ndihmojmë me këshillim profesional, përgatitje dokumentesh dhe mbështetje të plotë gjatë aplikimit.

Na kontaktoni sot për një të ardhme më të sigurt në Mbretërinë e Bashkuar.

Ekspertë të besuar të imigracionit.



- 07494181220
- 07435119343
- 02080902488



Ashley House 235 - 239
High Road, Wood Green,
London N22 8HF

ARBEN MANAJ

Ambasadori shqiptar në Mbretërinë e Bashkuar, Uran Ferizi, përmes një letre drejtuar gazetës britanike The Guardian, ka ngritur zërin në mbrojtje të komunitetit shqiptar në Britani duke kritikuar ashpër stigmatizimin që, sipas tij, po u bëhet qytetarëve të ligjshëm, punëtorëve dhe profesionistëve shqiptarë nga disa media dhe politikanë të krahut të djathtë. Ai thekson se ky perceptim i padrejtë po ndikon negativisht në jetën e përditshme të komunitetit shqiptar dhe po ushqen paragjykimet e rrezikshme në shoqërinë britanike shkruan Diaspora Shqiptare.

“Shqiptarët në Mbretërinë e Bashkuar, po bëhen kokë turku nga mediat dhe politikanët e krahut të djathtë”, thotë ambasadori Uran Ferizi në letrën drejtuar gazetës “The Guardian” ku kritikon ‘obsesionin’ me demonizimin e shqiptarëve

Janë shqiptarët në Britani që po paguajnë çmimin e këtij obsesioni nga mediat dhe politikanët e krahut të djathtë në shkolla dhe vende pune tha ambasadori shqiptar.

Uran Ferizi gjithashtu kritikon edhe sekretaren e brendshme Shabana Mahmood për komentet në parlament ku ajo ju referua shqiptarëve tek diskutoi problemet me emigracionin.

“Obsesioni me demonizimin e shqiptarëve ka arritur në foltoret e parlamentit”, tha ambasadori për The Guardian.

“Kur një ministër përmend një kombësi në parlament, në vend të një sjelljeje ose një lloji të caktuar krimi, atëherë nuk po përshkruan një problem, por po krijon një shënjestër.” Ferizi, përvoja e parë e të cilit në Britani ishte si adoleshent migrant i

Veprat penale të lidhura me pastrimin e parave në Shqipëri u rritën në nivelin më të lartë të dekadës së fundit, duke treguar për një intensifikim të aktivitetit financiar të dyshuar dhe të skemave gjithnjë e më të sofistikuar për futjen e fondeve të paligjshme në ekonomi.

Sipas të dhënave zyrtare të Institutit të Statistikave mbi krimet dhe drejtësinë penale, “Pastrimi i produkteve të veprës penale” arriti në 520 raste gjatë vitit 2025, me një rritje prej 11% krahasuar me një vit më parë. Ky nivel përbën rekordin më të lartë të regjistruar në 10 vitet e fundit dhe rikthen trendin rritës pas një periudhe dyvjeçare rënieje, që kishte nisur pas kulmit të mëparshëm prej 509 rastesh në vitin 2022.

Fenomeni i pastrimit të parave është bërë një nga çështjet më të ndjeshme të dekadës në Shqipëri. Në një dokument zyrtar të qeverisë të publikuar për konsultim në tetor të vitit të

paligjshëm përpara se të vazhdonte të studionte matematikë në Universitetin e Oksfordit katër vjet më vonë, përdori një letër drejtuar Guardian për të ngritur çështjen e asaj që ai e karakterizoi si keqraportim të statistikave në Telegraph (tjetër media britanike) dhe media të tjera në lidhje me shkallën e përfshirjes së shqiptarëve në krimin në Mbretërinë e Bashkuar.

Por ai gjithashtu në letrën dërguar Guardian zgjeron kritikën, duke ngritur në mënyrë implicite çështjen e komenteve të politikanëve me origjinë jo britanike, brez i dytë apo i tretë i familjeve migrante në Britani përfshirë Mahmood, Suella Braverman dhe të tjerë.

“Është veçanërisht dekurajuese të shohësh politikanë që janë vetë emigrantë të gjeneratës së dytë duke sulmuar emigrantët që i kanë ndjekur ata në Britani,” tha ai.

Ambasadori tha se ndikimi i portretizimeve negative të shqiptarëve në media dhe nga politikanët është ndjerë nga komuniteti, duke përfshirë këtu punëtorët, familjet dhe nxënësit e shkollës raporton Diaspora Shqiptare.

“Është krijuar një model në shtypin britanik në të cilin statistikë selektive zhvishen nga konteksti dhe amplifikohen”, shkruan ambasadori në letrën e tij.

Ferizi citon gjithashtu një analizë të publikuar në Daily Telegraph në vitin 2024, e cila pohonte se një në 50 shqiptarë në Mbretërinë e Bashkuar ishte në burg, shkalla më e keqe nga çdo kombësi. Megjithatë, ai tha se kjo ishte arritur nga një proces “që in-

joron procedurat më elementare për të siguruar saktësinë statistikore”.

“Nëse numri i shqiptarëve në burg peshohet me numrin aktual të shqiptarëve në Mbretërinë e Bashkuar, jo vetëm me një nëngrup shumë të vogël të tyre, dhe kontrollohet për seks, moshë dhe të ardhura, rezultati është se shqiptarët burgosen me të njëjtën shkallë si britanikët vendas. Por kjo nuk e përforcon paragjykimin se shqiptarët janë një grup jashtëzakonisht kriminal, kështu që nuk botohet.”

Ambasadori e krahason këtë damkosje negative të shqiptarëve me përvojën e grupeve të mëparshme të emigrantëve në Mbretërinë e Bashkuar.

“Janë prekur hebrenjtë, irlandezët, polakët. Çdo herë rrefimi zbulonte ankthet e momentit në vend të karakterit të njerëzve”, tha ai.

Referenca e ambasadores ndaj Mahmood ishte në lidhje me komentet e saj në parlament në nëntor, kur ajo paraqiti plane kontraverse për ndryshimin më të madh të ligjeve të azilit në 40 vjet.

E pyetur nga kolegja e saj deputete laburiste Stella Creasy në lidhje me implikimet për fëmijët, sekretarja e brendshme tha se ishte i nevojshëm konteksti në lidhje me “familjet e dështuara që kërkonin azil”.

“Aktualisht ka 700 familje shqiptare që kanë bërë kërkesa për azil dhe kërkesat e të cilave për azil kanë dështuar”, tha ajo.

Shqiptarët në Mbretërinë e Bashkuar ngurrojnë të flasin publikisht për për-



vojat e tyre negative, por një numër rastesh iu cituan Guardian nga ambasada.

Ato përfshinin një grua të suksesshme shqiptare në sektorin e teknologjisë, e cila ngurronte të ndante një postim në LinkedIn në lidhje me një ngjarje në Shqipëri, pasi u bënë komente në funksionet e punës për shqiptarët si “kriminelë dhe të rrezikshëm”.

Ajo dhe të tjerë gjithashtu tregojnë se kishin përjetuar diskriminim kur bëhej fjalë për ngritjet në detyrë.

Ariseld Muca, i cili drejton një kompani në sektorin e mirëmbajtjes së pronave në Londër, postoi në Instagram rreth përvojës së tij, në të cilën klientët vazhdimisht sillnin lajme rreth “kriminelëve shqiptarë”.

“Si mund ta mbyll marrëveshjen kur klientët e mi më pyesin nga jam dhe

e tëra që dëgjojnë në lajme është se kriminelët shqiptarë po pushtojnë Londrën?” tha ai.

Një zëdhënës i Ministrisë së Brendshme tha: “Ne e vlerësojmë shumë komunitetin shqiptar në Mbretërinë e Bashkuar dhe partneritetin tonë të gjatë me qeverinë shqiptare për të goditur migrimin e paligjshëm dhe kriminalitetin.

“Kushdo, pavarësisht kombësisë, që është në Mbretërinë e Bashkuar në mënyrë të paligjshme, nuk duhet të ketë dyshime se do të largohet sa më shpejt të jetë e mundur.”

“Telegraph është kontaktuar për koment” përfundon shkrimin “The Guardian”.

PASTRIMI I PARAVE NË SHQIPËRI ARRITI REKORDIN E 10 VITEVE TË FUNDIT

kaluar, Strategjia Kombëtare për Krimin e Organizuar 2026–2030 pranon se “transaksionet e paligjshme financiare dhe krimet financiare që lidhen me to janë ndikuar nga përshtetimi i teknologjisë dhe globalizimit”

Sipas të njëjtit dokument, “këto përfshijnë një gamë të gjerë aktivitetesh kriminale, të tilla si pastrimi i parave, evazioni fiskal, korrupsioni, trafikimi i drogës dhe trafikimi i qenieve njerëzore, të cilat shpesh u mundësojnë organizatave kriminale dhe terroriste të financojnë operacionet e tyre.”

Strategjia sillte në vëmendje në mënyrë të detajuar disa nga format e rrezikut të pastrimit të parave të identifikuar në Shqipëri duke i grupuar

ato, diçka që është në një linjë edhe me tipologjitë që ka identifikuar ndër vite edhe Agjencia e Inteligjencës Financiare. Këto kategori përfshijnë:

– Pastrimi i fondeve nga një sërë veprash penale të kryera jashtë vendit (vepra penale të lidhura me trafikimin e lëndëve narkotike, apo edhe vepra penale të kryera nga krimi i organizuar, vjedhja e pasurisë) nëpërmjet përdorimit të sistemit financiar formal, transportit ndërkontinental të parave cash, investimeve në pasuri të paluajtshme;

– Pastrimi i fondeve nga mashtrimet (përfshirë mashtrimet kompjuterike dhe në fushën e investimeve në “platforma” investuese të pa licencuara), të kryera jashtë vendit ose në Shqipëri

nga individë apo grupet e organizuara kriminale përmes përdorimit të sistemit financiar me pasojë transferimin e fondeve në juridiksione të tjera ose tërheqjen në para cash;

– Pastrimi i fondeve nga krimet që lidhen me fushën e tatimeve (fshehja e të ardhurave dhe mashtrimi i TVSH), duke përdorur personat juridik rezident, duke mos deklaruar bilance dhe faturimet reale, nëpërmjet regjistrimit të personave juridik që nuk kryejnë aktivitet real në Shqipëri (shoqëri fiktive), nëpërmjet përdorimit të sistemit financiar formal, investimeve në pasuri të paluajtshme; – Pastrimi i të ardhurave nga korrupsioni përmes përdorimit herë pas here të palëve të treta (individë dhe persona juridik) që shërbejnë për të ka-

mufluar mekanizmin, integrimi i mëvonshëm në instrumente financiare, pasuri të paluajtshme brenda vendit, apo biznese; – Pastrimi i parave duke përdorur persona juridikë rezident (kryesisht të formës shpk dhe më rrallë forma të tjera juridike) ose persona të tretë individë brenda ose jashtë rrethit të ngushtë të personit që është gjenerues i të ardhurave kriminale.

Të dhënat lënë hapësirë për tezën që diskutohet shpesh se pastrimi i parave mbetet i lidhur ngushtë me zhvillimin e tregut informal dhe përdorimin sidomos të pasurive të paluajtshme si instrument kryesor për futjen e këtyre parave në ekonomi edhe pse jo i vetmi. /Monitor



INTERNATIONS
LEGAL SOLICITOR

1st Floor Rear, Duru House
101 Commercial Road
London E1 1RD

Në gjuhën shqipe kontaktoni Besma Canameti 07533 870466

Ne ofrojmë mbështetje ligjore profesionale në një gamë të gjerë fushash për t'iu lehtësuar jetën:

IMMIGRATION LAW

Ndihmë me viza, qëndrim, shtetësi dhe të gjitha çështjet e imigracionit

COMMERCIAL LEASES

Udhëzim për bizneset në marrëveshjet e qirasë, rinovime dhe mosmarrëveshie.

FAMILY LAW

Mbështetje për divorcim, kujdesin për fëmijët dhe çështje të tjera familjare.

LANDLORD AND TENANT

Ndihmë për pronarët dhe qiraxhinitë në marrëveshjet, të drejtat dhe mosmarrëveshjet.

LITIGATION & JUDICIAL REVIEW

Përfaqësim në gjykatë dhe trajtimi i sfidave ligjore kundër institucioneve publike.

EMPLOYMENT LAW etc

Këshillim mbi të drejtat në vendin e punës, kontrata, mosmarrëveshie dhe shkelje.



Tel: 020 4618 7500



**KONSULTIMET
FALAS**

Pak ditë më parë, Ambasadori i Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar, Uran Ferizi, përmes një letre drejtuar gazetës "The Guardian", kritikoi qëndrimet e zyrtarëve britanikë ndaj emigrantëve shqiptarë. Ai theksoi se përmendja e shqiptarëve si komunitet me probleme me ligjin krijon stereotipe dhe i vendos ata në shënjestër.

Në një reagim për këtë çështje, ambasadori britanik në Tiranë, Nicholas Abbott deklaroi në një intervistë për Euronews Albania se duhet treguar kujdes me statistikën dhe mënyrën si interpretohen ato.

Diplomati britanik theksoi se shumica e shqiptarëve në Mbretërinë e Bashkuar jetojnë normalisht, punojnë dhe kontribuojnë në ekonomi. Megjithatë, ai pranoi edhe një realitet tjetër: "Shtetasit shqiptarë janë grupi më i madh i të huajve të dënuar në burgjet e Mbretërisë së Bashkuar. Ky është një fakt që nuk mund të shpërfillet," tha ai.

Pjesë nga intervista:

Nicholas Abbott: Do të isha shumë dakord me ambasadorin Farizi, se duhet të jemi shumë të kujdesshëm me statistikën, me shifrat që përdorin njerëzit dhe me realitetin që qëndron pas tyre.

Mendoj se ai ka plotësisht të drejtë ta ngrëjë këtë çështje. Prandaj ai dhe unë kemi një bisedë të gjatë mbi pyetjen se kë do të konsideronit shqiptar në Mbretërinë e Bashkuar.

Ai do të përfshinte edhe ata që kanë emigruar nga Italia apo Greqia, por që kanë identitetin etnik shqiptar. Si qev

AMBASADORI BRITANIK: GRUPI MË I MADH I TË DËNUARËVE NË MBRETËRINË E BASHKUAR JANË SHQIPTARË



eri, ne nuk veprojmë kështu.

Ne i konsiderojmë shtetas shqiptarë ata që kanë pasaportë shqiptare dhe hyjnë në Mbretërinë e Bashkuar me të. Pra, nuk është kaq e thjeshtë. Shumica e shqiptarëve që jetojnë në Mbretërinë e Bashkuar bëjnë jetë normale, jetë krejt normale, si njerëzit këtu. Ata kanë punë.

Kontribuojnë në ekonomi. Kanë fëmijë që shkojnë në shkollë. Mund të kenë familjarë që jetojnë në Britani dhe marrin trajtim mjekësor.

Por ka edhe një realitet që qeveria nuk mund ta shpërfillë. Shtetasit shqiptarë janë grupi më i madh i të huajve të dënuar në burgjet e Mbretërisë së Bashkuar.

Ky është realitet. Nuk synon aspak të demonizojë askënd. Dhe mendoj se mesazhi im, qoftë kur flas me ambasadorin Farizi, qoftë kur flas me pjesëtarë të diasporës në Mbretërinë e Bashkuar, apo me ata që vijnë këtu, është i njëjtë.

Kohët e fundit pata një vizitë nga një grup biznesmenësh të suksesshëm që jetojnë në Londër. Nuk po flas për

njerëz që drejtojnë kompani të mëdha. Janë kompani familjare. Por ata kanë qenë atje për gati 30 vjet. Kanë pasur sukses. Janë vendosur atje me familjet e tyre.

Ata më pyesnin: çfarë mund të bëjmë tani për vendin tonë? Si mund të na ndihmoni këtu në Shqipëri? Dhe unë qesh pak, sepse më duket sikur tani kam një lloj elektorati shqiptar që përfaqësoj.

Pra ambasador ju nuk bini dakord me kryeministrin Edi Rama, kur thote qe krimi nuk ka kombesi?

Nicholas Abbott: Po. Mendoj se është më e ndërlikuar se kaq. Duhet parë mënyra se si krimi ekziston brenda shoqërive të ndryshme, dhe si funksionon ai.

Ajo që ka ndodhur është se grupet kriminale shqiptare kanë arritur të krijojnë terren dhe të marrin kontrollin e disa fushave të krimit në Mbretërinë e Bashkuar.

Me sa kuptoj, në Gjermani, Francë apo Holandë, janë grupe të tjera. Kaq është. Pra, askush nuk po thotë se pas kriminalitetit në Evropën Perëndimore qëndron një mendje shqiptare që drejton gjithçka.

Por ekziston një realitet: grupet kriminale shqiptare janë të përfshira fort në trafikun e kokainës, në kanabis, në Mbretërinë e Bashkuar, por edhe në Evropën Perëndimore dhe më gjerë. Këto janë çështje që duhen përballur drejtpërdrejt.

Sepse, për ta bërë këtë, duhet bashkëpunim për t'i ndaluar. Dhe mendoj se kjo nuk është diçka që zgjidhet njëherë e përgjithmonë.

Nuk do të vijë një ditë kur kjo të marrë fund. Ajo që përpiqesh të bësh është të menaxhosh rreziqet për shoqërinë tënde, në mënyrë që ato të mos kenë ndikim shkatërrues mbi vetë shoqërinë. Kjo vlen edhe këtu, në Shqipëri. Askush nuk do të donte ta shihte këtë këtu. euronews.al

Dotech

website 

“ **AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE PËR BIZNESIN TUAJ?** ”

Akoma nuk jeni regjistruar në Google?

Adresa e zyrave:

30 Avenons Road London E13 8HT



Tel: 020 7018 7929



Mob: 073 4066 5946



Mob: 078 5997 7545



The Albanian

ANDI BUSHATI

Dosja e bandës së Ergys Agasit është më e rënda deri më sot, pasi përpos korrupsionit aty ndeshemi me një sistem të përparuar të fshehjes së pronave të padëklaruar e mbi të gjitha me rrëmbime personash

Në aqualand-in e madh të peshkaqenëve, që është kthyer qeverisja e rilindjes, bazeni i AKSHI-it është ai më i frikshmi.

Natyrisht dikush mund të vërë bast se këtë rekord e mban vjedhja me inceneratorët, ku firuan mbi 400 milionë euro, pa bërë asnjë lek punë.

Një tjetër mund të këmbëngulë, se skema e shpikur nga drejtorët e 5D-së, që vetë i jepnin tenderat dhe vetë i fitonin, as nuk qe parë, as nuk qe dëgjuar.

Një i tretë nuk do bënte dot paqe me galaksinë e kompanive dhe OJF-ve që ishin krijuar rreth Veliajt, satelitët e së cilës vërtiteshin për të pasuruar të shoqen.

Por, me një të rënë injoruese të lapsit, dikush më kokëfortë, mund t'i reduktojnë përmasat e këtyre krimeve, pasi të kishte lexuar dosjen e Belinda Ballukut dhe mënyrën se si ajo shpërndante qindra miliona euro para publike, vetëm përmes celularit të saj.

LUTFI DERVISHI

Ka ende frikë nga ideja e transmetimit televiziv të gjyqeve me interes të lartë publik.

Megjithatë, koha e "burimeve pranë hetimit", "burimeve të mia" dhe fragmenteve selektive duhet të marrë fund. Drejtësia që fshihet prodhon pashmangshmërisht dyshim, ndërsa drejtësia që nuk ka frikë kameran, prodhon autoritet.

Kur në bankën e të akuzuarve ulen figura VIP, interesi i publikut është më shumë se kureshtje, është detyrim llogaridhënieje. Këto procese sa çështje private ku secili bërë varet nga këmbët e veta, janë edhe teste për vetë sistemin. Këtu nuk gjykohet vetëm individi, për atë që ka bërë apo nuk ka bërë...

Argumenti se transmetimi "do ta kthejë gjyqin në cirk" është ca i vjetruar. Cirk bëhet kur informacioni rrjedh me pika, kur narrativa ndërtohet mbi gjysmë të vërteta, sajesa, shpifje dhe kur publiku lihet në mëshirë të interpretimeve të nallbanëve.

Transparenca e plotë e vret cirkun sepse e zëvendëson thashethemin me faktin.

Historia është e mbushur me shembuj

Ç'MËSUAM TË RE PËR "FOLENË E PESHKAQENËVE" NË AKSH



E megjithatë, megjithatë, sado drithëruese të jenë këto skandale që konkurrojnë denjësisht me njëra-tjetër nga kreativiteti për të vjedhur, ajo që ka ndodhur në maternitetin e Diellës, është e pakrahasueshme me asgjë nga paraaradheset.

Dhe këtu nuk është puna vetëm te sasia e parave të grabitura, por te sistemi që kishte ngritur në këmbë ky grup kriminal.

Po të lexoje të plotë 52 faqet e dosjes së "rrjedhur" nga GJKKO, e cila sekuestroi rreth 40 milionë euro pasuri të Ergys Agasit, Ermal Beqirit

dhe ish-drejtoreshës Mirlinda Karçanaj, e ke më të lehtë të mbërrish në këtë përfundim. Nëse në rastet e tjera të aktakuzave që ka ngritur deri më tani SPAK-u, fshehja e pronave të përfuara përmes korrupsionit ngelet në nivel amator, në këto faqe shikohet se sofistikimi ka kapur tjetër stad.

Tanimë nuk kemi të bëjmë me pasuri të kaluara në emër të një familjari, të një kushëriri, të një miku biznesmen. Jo! Fshehjen e pasurive të përfuara nga marrëveshjet e errëta këtu e marrin në dorë kompani të strukturuar, të cilat janë vetë përfitueset e parave publike të shpërndara nga zyrtari që do të kamuflojë pronësinë reale.

Po të qëmtosh historikun e pronave që dyshohet se ka fshehur ish-drejtoresha, atë një herë e bën, përmes një biznesmeni, Ergys Agasi, në xhepat e të cilit përfundonin paratë e garave fallco dhe një herë tjetër Ermal Beqiri, që ka organizuar të gjithë kompaninë e tij për të fshehur pasuritë e zyrtares që e favorizon.

Përpos ndonjë përjashtimi kur mijëra euro jepen në kartone verërash, marrëdhënia e ka tejkaluar atë ndërmjet rryshfethënësit dhe rryshfetmarrësit. Grupi nuk kujdeset vetëm se sa para do të duhej t'i shkonin në xhep drejtoreshës, por edhe se si ajo nuk duhet të binte në sy për shumat e fituara.

Pra, edhe shqetësimi për t'i fshehur gjurmët e krimit është disa fish më i kamufluar. E pavarësisht kësaj, e gjitha nuk përfundon këtu.

Ka një episod në dosje, kur biznesmenes shqiptaro-gjermane, Migena Shroeder, kërkohet t'i imponohet me anë të kërcënimit, mënyra e pagesës nën dorë për paratë e fituara nga puna që kishte marrë përsipër.

Ajo këshillohet nga Mirlinda Karçanaj të takojë Ermal Beqirin.

Fjalja e tij është: "Je futur në një pishinë peshkaqenësh". Këta grabitqarë dyshohet se kanë bërë të njëjtën gjë me bashkëjetuesin e saj gjerman, njësoj siç bënë me Geron Meçen, apo Daniel Shimën.

Pra përpos sofistikimit në fshehjen e pasurive, metodat e kërcënimit, duke shkuar deri në rrëmbime, herë me ndihmën e grupeve më të rrezikshme kriminale dhe herë me bashkëpunimin e policisë, e bëjnë grupin e AKSHI-it, një monstër që të kall datën.

Për ta skicuar edhe më të ububueshme të gjithë këtë tablo të errët, nuk ka nevojë të shtohet se tarifa e suksesit të vjedhjeve dhe rrëmbimeve, celebruhej në zyrën e kryeministrit, duke hapur tapat 30 mijë euroshe të shisheve Romanee Conti, që tashmë nuk ka dyshime se nga kush silleshin e ku konsumoheshin.

Pikërisht për të gjithë këto elementë dosja e AKSHI-it nuk ka konkurrentë. Jo vetëm se aty është kapur me zë dhe figurë, "koordinatori i kryeministrit me krimin", por se pikërisht ai, Ergys Agasi, kishte arritur të formonte një shtet brenda shtetit, me të cilin po të kishe punë, të shqyenin peshkaqenët.

KAMERA SI VETTING I DYTË I DREJTËSISË



të bujshëm të gjyqeve të rëndësishme ku kanë spikatur profesionistët.

Ëndrra e një gjyqtari, prokurori, avokati duhet të jetë një çështje e madhe ku ai t'i tregojë të gjithëve sa "i vlen lëkura"

Nga proceset e Nurembergut te skandalin "Watergate", nga gjyqi i O.J. Simpson te Gjykata e Hagës, koha ka vërtetuar se kamera nuk e dëmton procesin, por e lartëson atë.

Po, ka pasur tension dhe dramë, por mbi të gjitha, kemi parë një standard

profesional.

Publiku ka parë me sytë e tij se kush flet me prova dhe kush rreh ujë në havan; kush është i përgatitur dhe kush improvizon, kush është profesionist dhe kush është sharlatan. Kush është i zoti dhe kush është mediokër.

Në një sallë gjyqi të hapur, ku çdo fjalë transmetohet në kohë reale, "i del kallaj" kujtdo:

Aty prokurori nuk mund të mburret me dosje mijëra faqesh që nuk mbështeten në fakte. Mjafton një faqe për të bindur publikun. Madje edhe një paragraf.

Avokati nuk mund të fshihet pas aktrimit televiziv pa substancë ligjore, as pa retorikes politike.

Gjyqtari nuk mund të maskojë paaftësinë apo anshmërinë apo frikën, pas vendimeve të paarsyetur.

Dëshmitari e ka të pamundur të luajë me të vërtetën pa u ekspozuar para miliona syve.

Në fund të ditës, ai që fiton nuk është

ai që bërtet apo ai që ka më shumë akses në media, por ai që ka të vërtetën me vete dhe zotësinë profesionale për ta mbrojtur atë.

Pas një dekade investimesh dhe debatesh për Reformën në Drejtësi, pyetja nuk është më a kemi ngritur institucione dhe godina të reja, por a kemi profesionistë që nuk kanë frikë nga kamera/drita?!

Një gjyq i transmetuar "live" është provimi ku të gjithë dalim të fituar.

Nëse drejtësia funksionon, besimi i publikut rritet pashmangshmërisht. Mbështetja për drejtësinë mund të arrijë edhe shifra sovjetike. Por edhe nëse drejtësia dështon, publiku dhe vetë sistemi identifikon saktësisht ku fle problemi. Në çdo rast shoqëria është e fituar.

Gjyqi publik nuk është rrezik për drejtësinë, është rrezik për mediokritetin dhe korrupsionin brenda sistemit. Një sistem që i druhet kamerës, nuk ka problem me teknologjinë, ka problem me veten.

BIRN

Të dhënat zyrtare të tregut të pasurive të paluajtshme në Shqipëri tregojnë një realitet që sfida rregullat bazë të ekonomisë. Shifrat e transaksioneve nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, ASHK, për periudhën 2021-2025, të kryqëzuara me ndryshimet demografike dhe të dhënat e INSTAT mbi lejet e ndërtimit zbulojnë një anomali të dukshme, ku volumi i ndërtimeve dhe çmimet e pronave vazhdojnë të rriten, ndërkohë që numri i shitjeve tkurret.

Të dhënat e siguruar përmes një kërkese për të drejtë informimi në ASHK tregojnë se pas një bume në vitin 2022, shitjet e apartamenteve në kryeqytet pësuan një tkurrje të ndjeshme dhe të vazhdueshme për dy vite me radhë, përpara se të shfaqnin një stabilizim dhe rritje të lehtë gjatë vitit 2025.

Në një ekonomi funksionale, ky do duhej të ishte momenti kur rregullat bazë hyjnë në lojë. Kur kërkesa bie dhe stoku i pashitur rritet, çmimet duhet të ulen për të nxitur blerësit. Megjithatë në Tiranë, çmimet e pronave pësuan një rritje agresive gjatë viteve 2023-2024, duke e bërë strehimin një mision të pamundur për qytetarin e shtresës së mesme.

Ky është thelbi i asaj që ekspertët e konsiderojnë si “paradoksi i betonit”; ku në vend që tregu të vetë-korrigjohet nga mungesa e blerësve tradicionalë, ai po mbahet peng nga blerësi atipik, i cili është imun ndaj kredive bankare dhe interesave.

“Sektori i ndërtimit përdoret si kanal për para informale dhe kriminale, duke ulur presionin për të shitur shpejt dhe duke lejuar mbajtjen e çmimeve të larta, pavarësisht nga të ardhurat reale të familjeve,” thotë Zef Preçi, drejtor i Qendrës Shqiptare për Kërkime Ekonomike.


Sipas tij, ky fluks informal kapitalësh ka krijuar një “mur” çmimesh, që sipas ekspertëve po deformon ekonominë kombëtare.

Të dhënat statistikore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës tregojnë se viti 2022 ishte “viti i artë” pas pandemisë për tregun e pasurive të paluajtshme, ndërsa vitet në vijim patën një rënie të shitjeve.

Në nivel kombëtar, trendi i shitjes së pronave shënoi një kulm absolut në vitin 2022 me 37,684 kontrata, i pasuar me një tkurrje thelbësore prej afro 17.2% deri në vitin 2024, duke zbritur në 31,199 kontrata. Tregu shënoi sërish rritje gjatë vitit 2025, ku u regjistruan 36,027 transaksione me pasuritë e paluajtshme.

Ndërsa numri i transaksioneve në nivel kombëtar u përmirësua, Tirana – e cila mban peshën kryesore me mbi 41% të transaksioneve në këto 5 vite, ende nuk ka arritur nivelin e shitjeve

"PARADOKSI I BETONIT" - ÇMIMET E PRONAVE RRITEN, NDËRSA SHITJET KANË PËSUAR TKURRJE



të vitit 2022. Të marra së bashku, 4 rajonet e ASHK në Tiranë regjistruan mbi 17 mijë transaksione në vitin 2022, ndërsa në vitin 2025 rreth 13 mijë.

Volumi i transaksioneve të ndodhura në kryeqytet, krahasuar me totalin në rang vendi, ra nga 45.5% në vitin 2022 në 36.5% në vitin 2025. Të dhënat tregojnë se tregu u zhvendos në vijën bregdetare dhe zona të tjera të vendit, që janë përgjegjëse edhe për atë që duket si një rimëkëmbje e tregut gjatë vitit të shkuar.

Për shembull, në zonën e mbuluar nga drejtoria “Tirana Veri”, e cila përfshin disa nga zonat me zhvillimin më të vullshëm, përfshirë Bulevardin e Ri, në vitin 2021 u regjistruan 4,735 kontrata shitjeje dhe u rrit në 6,201 transaksione në vitin 2022.

Por pas këtij momenti tregu ra. Në vitin 2023 numri i shitjeve ra në 4,729, dhe në vitin 2024 preku fundin e këtij cikli me vetëm 4,073 kontrata, një rënie drastike prej afro 35% krahasuar me vitin e bumit.

Sipas Ylli Sulës, drejtues i kompanisë “Çelësi” që përpilon indeksin e çmimeve “Keydata”, kjo është zona me çmimet më të ulëta në kryeqytet.

“Parë nga ky këndvështrim relativ, kjo zonë mbetet, si edhe para kërcimit të çmimeve prej vitit 2022, zona me çmimet më të ulëta në Tiranë,” thotë Sula.

Ai e shpjegon rënien e transaksioneve me rënien e numrave të migrimin të brendshëm dhe pamundësinë e këtij

grupi që lëviz nga rrethet drejt Tiranës për të blerë me çmimet aktuale.

“Për sa i takon rënies së vëllimit të kontratave në këtë zonë, interpretimi ynë e lidh këtë dukuri kryesisht me rënien e fluksit migrator të brendshëm drejt kryeqytetit nga shtresa e blerësve me nivel të ulët ekonomik që ka përbërë ndër vite potencialin kryesor për këtë zonë dhe me pamundësinë e kësaj shtrese për të përballuar këtë nivel rritjeje çmimi”, tha ai.

Një trajektore e ngjashme vërehet edhe në atë zonë që njihet si “Tirana Jug”, që përfshin qendrën e Tiranës dhe pjesën e lakmuar rreth parkut të Liqenit Artificial. Nga 3,960 kontrata në 2022, shifra në këtë zonë ra në 3,109 në vitin 2024. Jugu i kryeqytetit pati një rikthim më të fortë në vitin 2025, por sërish pa arritur shifrat e dy viteve më parë.

Sipas indeksit “KeyData” të kompanisë Çelësi, çmimet e pronave në kryeqytet për 3 vitet e fundit [2023-2025] janë rritur mes 49.4% në zonën veriore deri në 74.9 për qind në zonat e tjera të Tiranës.

Për ekspertin e ekonomisë, Zef Preçi, rritja e çmimeve pavarësisht rënies së kërkesës ka një sërë faktorësh, që përfshijnë kostot më të larta, rritjen e taksave vendore dhe qendrore, rritjen e çmimeve të referencës dhe një treg spekulativ me prani të madhe parash të pista.

“Ka disa tregues ku mund të dyshohet me bazë për prezencë parash të pista në sektorin e ndërtimit, por asnjëri nuk është ‘provë’ i vetëm,” thotë ai, duke përmendur format e financimit

të projekteve luksoze në kryeqytet që po zhvillohen nga kompani pa kapital të qartë.

Për të, ngritja e kullave të mëdha pa marrë kredi është një sinjal i qartë rreziku.

“Kemi kompani ndërtimi me xhiro shumë të ulët të deklaruar ndër vite, që papritur marrin leje për projekte dhjetëra milionë euro dhe nuk raportojnë burimin e kapitalit, ose kanë strukturë pronësie me zinxhir shoqërisht guackë, shpesh off-shore,” thekson Preçi.

Edhe Eduard Gjokutaj, drejtues i qendrës kërkimore ekonomike ALTAX, shpjegon se rritja e çmimeve po udhëhiqet “nga një kërkesë selektive e përqendruar në segmentet premium.” Kjo krijon atë që ai e quan “investitor jo-elastik”, një profil që zotëron likuiditet të bollshëm dhe nuk reagon ndaj luhatjeve të çmimit.

Për ekspertët, ky treg që dominohet nga blerës që nuk pyesin për çmimet është dëshmi i ekonomisë informale dhe dyshimeve për pastrim parash. Eduard Gjokutaj paralajmëron se peizazhi financiar i Tiranës nuk mund të analizohet pa marrë parasysh “flamujt e kuq” që valëviten mbi këtë sektor.

“Boshllëku sistematik mes çmimeve të deklaruar në kontrata dhe vlerës reale të tregut është sinjali i parë i një ekonomie paralele,” thekson ai. Sipas tij, ky fenomen vërtetohet lehtësisht nga një tjetër anomali: “Një raport jashtëzakonisht i ulët i kredive hipotekore kundrejt transaksioneve totale, çka sugjeron se një pjesë e konsiderueshme e pasurive të paluajtshme po përthithet nga likuiditeti jashtë sistemit bankar.”

Po ashtu, një tjetër sinjal alarmi janë të ashtuquajturat “flip transactions” apo rishitja e shpejtë e pronave: “Pa pasur asnjë funksion real banimi apo ekonomik, tregun për një natyrë spekulative të tregut,” theksoi Gjokutaj.

Të dhënat e Censurit të Popullsisë dhe Banesave 2023 nga INSTAT tregojnë se popullsia banuese në Shqipëri ka pësuar një rënie drastike krahasuar me vitin 2011, një fenomen që prek pothuajse të gjithë vendin.

Qarku i Tiranës është i vetmi që ende shënon një shtesë populsi, falë urbanizimit të vazhdueshëm dhe migrimin të brendshëm drejt kryeqytetit. Por pavarësisht kësaj rritjeje populsi, në vitin 2023 në Bashkinë e Tiranës numëroheshin 52,800 banesa të pabanuara. Të llogaritura mbi një

sipërfaqe mesatare konservatore prej 80 metrash katrorë dhe çmimin mesatar të referencës shtetërore në kryeqytet rreth 1,290 Euro për metër katror, këto objekte bosh përfaqësojnë afro 5 miliardë euro kapital të “ngjirë”.

Pavarësisht rënies së popullsisë, të dhënat e INSTAT tregojnë se në vitin 2024 u dha leje për 2.4 milionë metra katrorë sipërfaqe të reja ndërtimi. Në vitin 2025, sipërfaqja ra në 1.3 milionë metra katrorë.

Kjo situatë po kërcënon, sipas ekspertëve, strukturën makroekonomike të vendit. Për Zef Preçin, ky është një paradoks i thellë pasi vëllimi aktual i ndërtimeve nuk mbështetet në asnjë projektion makroekonomik real.

“FMN dhe institucionet e tjera presin rritje reale të PBB-së rreth 3-4% në vit në dekadën e ardhshme... kjo nuk mjafton për të justifikuar që ndërtimi të zërë një peshë kaq të madhe në investimet totale, duke arritur rreth gjysmën e investimeve në disa vite,” shpjegon ai.

Kjo mani për të hedhur paratë në beton po krijon pasojë zinxhir. Preçi përdor termin “Kulla të zbrazëta” për të përshkruar mijëra apartamente dhe zyra të pashfrytëzuara që mbajnë të bllokuara vlera të mëdha investimi.

“Sa më shumë kapital mbahet në godina bosh, aq më pak kapital ngelet për sektorë që rrisin produktivitetin dhe eksportet, duke frenuar rritjen afatgjatë të PBB-së,” paralajmëron Preçi.

Edhe Gjokutaj thekson të njëjtën pikë se ndërtimi ka braktisur funksionin e tij social.

“Prona po përdoret si një ‘magazinë vlerë’, e ushqyer nga urbanizimi i brendshëm drejt kryeqytetit dhe kërkesa e diasporës,” tha ai.

Sipas tij, Shqipëria rrezikon të futet në atë që në ekonomi njihet si “Sëmundja Holandeze”, kur forcimi i monedhës vendase për shkak të hyrjeve të mëdha të valutës për të blerë pasuri të paluajtshme cenon pjesën tjetër të ekonomisë.

“Jemi në kushte të përkufizuara si ‘Dutch Disease’, ku përqendrimi i tepërt në një sektor (ndërtim) ‘vret’ sektorët e tjerë konkurrues duke rritur kostot e inputeve (punës dhe tokës)”, thotë Gjokutaj. Kjo situatë sipas tij krijon një “iluzion pasurie”, ndërkohë që lë të nënfinancuar sektorët prodhues dhe ata inovativë, duke goditur zhvillimin e qëndrueshëm afatgjatë. /BIRN



**HARINGEY
HOSPITAL**

Shërbime Shëndetësore Private në Londër për Komunitetin Shqiptar

E njëjta klinikë e besuar — tani **Haringey Hospital**
(i njohur më parë si Medipark Clinic)

URGJENCA

MJEKU I FAMILJES (GP)

MJEKË KONSULTANTË

IMAZHERI & LABORATOR

ANALIZA GJAKU

KLINIKË DENTARE

FARMACI

Shërbim në gjuhën shqipe

- Mjekë specialistë
- Teknologji moderne
- Kujdes profesional

Komuniteti shqiptar në Londër na beson.



573–575 Green Lanes
Harringay Ladder, London N8 ORL



0208 341 3185



+44 7947 785174



www.haringeyhospital.com

ENDE NUK KENI NJË WEBSITE?

ENDE NUK JENI REGJISTRUAR NË GOOGLE?

Dotech
website 

ADRESA E ZYRAVE
30 Avenons Road
London E13 8HT



Tel: 020 7018 7929
Mob: 073 4066 5946
Mob: 078 5997 7545

JUGOSLLAVIA ISHTE KRIJUAR ME QËLLIM QË SERBËT TË ISHIN FITUES TË PËRHERSHËM KURSE SHQIPTARËT HUMBËS TË PËRHERSHËM

DAUT DAUTI

Kur në vitin 1961 Ivo Andriqi e mori Çmimin Nobel, Jugosllavia socialiste u ngrit në këmbë, por më së shumti u gëzuan serbët. Ivo Andriqi ishte kroat, por ishte konvertuar në serb. Në serb ishte konvertuar edhe Mehmed (Mesha) Selimoviq, i cili në këtë foto shihet në anën e majtë kurse pas iu shkon një gazetar serb.

Mesha vinte nga një familje e njohur myslimane boshnjake.

Sidoqoftë, që të dy u bënë shkrimtarë madhështorë serbë. Në fakt, shumica e atyre që merren me letërsi, me të drejtë mendojnë se Mesha ka qenë më i mirë dhe se ai do të duhej të ishte nobelist.

Sot, Ivo Andriqi zor se do ta merrte Nobelin për arsyet që e mori e që ishin dhënë në romanin fitues Ura mbi Dri.

Por, në fillim të viteve të 60-ta, në

Evropë mbretëronte tjetër atmosferë. Shto faktin që Andriqi kishte shprehur edhe qëndrime (zyrtarisht) fashiste anti shqiptare dhe gjërat janë të qarta.

Por, atëherë në politikën dhe diplomacinë evropiane shqiptarët janë neglizhuar sikur të ishin të paqenë, sidomos ata që jetonin në Jugosllavinë e dikurshme.

Në realitet, Jugosllavia ishte krijuar me qëllim që serbët të ishin fitues të përherëshëm kurse shqiptarët: humbës të përherëshëm.



AKOMA NUK KENI BUSINESS CARDS?

NA KONTAKTONI:

020 7018 7929

073 4066 5946

078 5997 7545

**PËR ÇDO KONSULTIM MUND TE VINI NË ÇDO KOHË NË ZYRAT TONA
ADRESA E ZYRAVE: 30 AVENONS ROAD,
LONDON, E13 8HT**



BUSINESS CARDS ME QR CODE

ZGJIDHNI PROFESIONISTËT PËR SUKSESIN E KOMPANISË TUAJ



VOLUNTEERS NEEDED!

WE NEED YOUR HELP!

Are you passionate about making a difference in people's lives? Do you want to help individuals facing challenges such as housing issues, welfare benefits, debt, immigration, and more?

We are looking for dedicated volunteers to join our Advice & Advocacy Team. This is a fantastic opportunity to gain hands-on experience, receive specialist training, and help increase our capacity to support vulnerable clients.

Contact us!

020 7511 1586
SHPRESAPROGRAMME@YAHOO.CO.UK
SHPRESAPROGRAMME.ORG


ALFRED LELA

Edi Rama po i jeton të përmbytura batutat dhe provokimet e veta. Dikur pat dalë me sëpatë në dorë për të prerë 'nyjën gordiane' të një shtylle druri, e shtrirë si kulla e Pizës në një prej anërrugëve ku ai donte të shtronte asfalt dhe t'ia mbillte këmbësoren me kumbulla të kuqe.

Dekadën e fundi e ka kaluar duke mbjellë pallate të kuq e gri, në të gjitha ato vende ku dikur gjendej ndonjë parkim modest, ndonjë shtyllë ngalakeqe apo ndonjë vilë zemërplasar tiranase, nga ato të kohës së Zogut. Sëpata e Ramës ka qenë në garë me sëpatën e Liktorit, por nëse italianja është shtrirë në një T simetrike dhe estetike, që ende e bën të durueshëm kryeqytetin, ajo e Ramës është ngritur përpjetë në formën e kullave, një fellatio e ish-artistit me ish-qtetin.

Një batutë tjetër e tij kish në qendër paranë. "Nuk ka bir nënë apo kurve që të gjejë në xhepat e mi para të vetat", shkon pak a shumë fjalja, që

QIRAXHINJTË MILIONERË TË EDI RAMËS



është hem akuzuese, hem mbrojtëse. Rama ka luajtur vazhdimisht artistin e rënë në dashuri me veprën dhe veten, të cili pak i interesojnë paratë. Vepra e tij politike ama, dëshmon një gjë tjetër. Ai e thelloi hedonizmin, e shtoi numrin e atyre me shumë para dhe me shumë babëzi rreth vetes, dhe e ktheu Shqipërinë në një vend të obsesionit me

. Para sa më shumë, me të gjitha

mënyrat, një makiavelizëm monetar ku parvenytë u pasuruan shpejt dhe pasuritë e vërteta u rralluan në favor të një sistemi të Vitit Zero.

Një Shqipëri e tillë nuk mund të mendojë për arsimin, sigurinë, kulturën, kohezionin shoqëror, por për ndërtime, resorte, koncerte, turizëm masiv të gjitha pjesë e një fasade të një 'kopshti Potemkin'.

E gjithë kjo kulturë e bumit monetar krijoi një klasë të re zyrtarësh dhe sekserësh të pushtetit, pasuria e të cilëve u rrit në mënyrë ekspozionale, në të njëjtin nivel me vendimin që zgjedhjet nuk janë një garë, por një plaçkë e cila i shkon më të fortit, pra atij me më shumë burime.

Kjo klasë mund të pagëzohet si superelektorët, një trupë e posaçme që menaxhon një infrastrukturë zgjedhore masive, nga A në Zh. Detyra e kësaj njësie speciale është, së pari të krijojë thesarin e zgjedhjeve, e dyta databazën e zgjedhësve, dhe e treta një sistem simulim-manipulimi, i cili

bën që votimet të duken si zgjedhje, ndërkohë që ato janë të paracaktuara, të vdekura pa hyrë në kuti.

Që zullumi të mbajë dhe të mos këputet, Rama u vu në krye të përpjekjeve, së pari për t'i fuqizuar këta individë të vendosur nëpër institucionet kyçe, dhe së dyti për t'u krijuar atyre (lexo vetes dhe PS) një narrativë mbrojtëse nëpërmjet përunjësive së 'shërbëtorit publik' që bën punën dhe jeton minimalisht.

Ilustrim i kësaj është Mirlinda Karcanaq e cila, sipas Ramës, jetonte me qera, kish pasë jetuar në shtëpinë e prindërve në një pallat të komunizmit, e të tjera këputjeshpirtë si këto.

Një sekuestro e SPAK zbuloi të vërtetën. Zyrtarët e AKSh, përfshirë drejtoreshën 'asketike' të Ramës, kishin akumuluar pasuri në dhjetra miliona euro. Mos harroni: kjo është vetëm pjesa e zbuluar; imagjinoni se sa miliona të tjerë gjenden, me gjasë, në banka offshore, në pasuri të palua-

jtshme jashtë nën emra të tjerë, apo në diamante dhe lingota ari, që janë të lehta për t'u zotëruar dhe fshehur.

Kjo zbulon, jo vetëm hipokrizinë e 'socialistëve të përvuajtur të shampanjës', por një vjedhje sistematike të shkallës industriale, e cila nuk mund të anashkalohet me batuta për ata 'që kanë kumbulla pas shpinës sime' apo broçkulla të ngjashme.

Strategjia e Ramës ka qenë e qartë: krijimi i një pasurie të tillë, personale dhe të grupit, që e bën të mundur manipulimin sistematik të zgjedhjeve. Edhe në rast të një të papriture dhe humbjes së tyre, kjo pasuri duhet të shërbejë si bazë për t'ia bërë jetën të pamundur kundërshtarit politik dhe për të montuar, në një kohë sa më të shpejtë, rikthimin në pushtet. Që do të thotë shqetësimi i Ramës në këtë 13 vjetësh në pushtet nuk ka qenë shteti, por deep state-i.

ARBEN KALLAMATA

Në vend që të organizojë mbledhje me emra bombastikë në Pallatin e Kongreseve, qeveria shqiptare do të bënte mirë të tregonte një minimum përgjegjësie për shtetasit e vet që jetojnë jashtë kufirit të Republikës së Shqipërisë. Sepse, para së gjithash, ne nuk jemi lopë, aq më pak lopa juaj.

Ajo që quhet diasporë është parë tradicionalisht nga ata që qeverisin Shqipërinë si lopë që duhet mjetë sa herë kujtohen ose kanë nevojë për të mjetë financiarisht dhe politikisht. Për krerët egocentrikë dhe të papërgjegjshëm që kanë drejtuar atë vend ndoshta që prej krijimit të tij, diaspora është një tufë mjeranësh që hyjnë në punë vetëm për të pompuar euro dhe dollarë drejt vendit duke lehtësuar disi nivelin e varfërisë, për ndonjë investim kur ua mban xhepi ose kur kanë ndonjë parë të pisët për të pastruar dhe, nëse është e mundur, për të "lobuar" imazhin dhe politikën idiote të diktatorucëve që si qëllim të vetëm kanë pasur zgjatjen e kohëmbajtjes së prapancave të tyre ngjitur pas karriges.

Ata që drejtojnë në Shqipëri duhet ta kenë të qartë që të gjithë shtetasit shqiptarë që janë larguar nga vendi e kanë bërë këtë jo për të kërkuar mundësi më të mëdha për t'iu shërbyer atyre apo kujt tjetër, por për një jetë më të mirë.

Sakrifica e paimagjinueshme e zhvendosjes nga vendlindja kryhet vetëm si pasojë e një presioni të jashtëzakonshëm.

Duke përjashtuar një përqindje të vogël profesionistësh që kanë ikur me oferta pune, pra për interesa karriere, shumica dërrmuese e milionave të

languarve janë nisur drejt të panjohurës dhe pasigurisë, të bindur se ato - e panjohura dhe pasiguria - janë më të mira se ajo që linin pas, mizerja ekonomike, mungesa elementeve më elementare të jetesës, kufizimi i lirisë, korrupsioni në çdo nivel të shoqërisë dhe veçanërisht në majë të saj, imoraliteti dhe shkelja e normave etike, pra një mjedis fare i papërshtatshëm për të përfytyruar një të ardhme për veten dhe pasardhësit.

Dhe përgjegjës për këto - deprivimet ekonomike, mungesën e lirisë, korrupsionin, imoralitetin dhe mjedisin e papërshtatshëm - janë të gjithë ata që kanë drejtuar shtetin shqiptar që nga Ismail Qemal Bej Vlora deri te Ismail Qemal Bej Rama, me një doze më të lartë përgjegjësie, kuptohet, për atë që qëndron kronologjikisht diku në mes të kësaj aradhe politikanësh të shëmtuar, diktatorin never hoxha.

Ky takëm të paafetsh (them të paafetsh sepse nën drejtimin e tyre Shqipëria për mëse një shekull ka mbetur ndër shtetet më të dobët ekonomikisht, më të pambrojtur ushtarakisht, më të pazhvilluar intelektualisht dhe më të korruptuar moralisht në Evropë) nuk bën asnjë përpjekje për të ndihmuar as ata që jetojnë brenda vendit dhe as ata që janë jashtë. Duke shfrytëzuar në mënyrë hileqare kartën e patriotizmit, ata përipiqen ta identifikojnë veten me atdheun, sundimin e tyre feudal me flamurin, krokëllimat e tyre me Himnin Kombëtar.

Shiheni skenën që kanë përballë përfaqësuesit e diasporës në Pallatin e

Kongreseve. Dy kokët e shqiponjës njësohen me kokën e Edi Ramës e kurrar që të jetë kopje e kokës së Ismail Qemalit. Ngado përflakje e kuqe dhe e zezë. Përflakje patriotike, frymëzim dykrenar, folklorizëm i shëmtuar. Nga podiumi Rama duket sikur thotë: "Ju, pjesa e Lopës që keni ardhur këtu, të jeni të sigurt se po mileni për atdheun. Dhe Atdheu jam unë: Ismail Qemal Rama me dy krena."

Nuk jam marrë me gjedh dhe bagëti, por të paktën diçka elementare e di - që të marrësh qumësht nga lopa duhet ta ushqesh. Jepi drejt ca bar që ta kthejë në qumësht. Këta qelbësira që drejtojnë Shqipërinë as bar nuk duan të japin. Përkundrazi, e trajtojnë emigrantin si plehrë, si diçka pa vlerë, e përdhosin sa herë që iu bie rasti, pastaj lëshohen si të babëzitur për ta mjetë.

Lexoni përmbledhjet e Samitit të Diasporës: nëm, nëm, nëm. Diaspora si potencial strategjik në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, përfshirja e diasporës në vendimarrje, investimet dhe inovacioni, kërkimi shkencor, ndihmesa në arsim, shëndetësi, kulturë dhe roli i saj në procesin e integritit.

S'është kujtuar njeri t'iu lehtësojë atyre që jetojnë jashtë Shqipërisë, le të themi, kryerjen e veprimeve elementare financiare apo administrative që kanë lidhje me pjesën e vendit që kanë lënë pas. Provo të hapësh dhe të mbash një llogari bankare nga larg. Ta bllokujnë kur të duash dhe duhet të heqësh picirin që ta ri-hapësh. Të

kërkojnë vërtetime gjallese dy herë në vit.

Provo ta kalosh pensionin në llogari të përbashkët me bashkëshortin/bashkëshorten. Nuk e pranojnë, sepse presin që njëri të vdesë dhe tjetri të mos ketë mundësi të tërheqë nga banka apo Sigurimet Shoqërore paratë që kanë mbetur.

Kërko të marrësh pensionin që të takon. Të nxjerrin ujin e zi. Le të tjerat, por kanë kaluar edhe një ligj arbitrar që iu mohon pensionin të gjithë atyre që kanë kontribuar më pak se 15 vjet. Duket si ligj i projektuar posaçërisht për emigrantët, për të mos lejuar me mijëra prej tyre që janë larguar pasi kanë punuar për vite në atdhe të marrin pjesën e parave që e kanë investuar.

Ku shkon kontributi i tyre për pensionin gjatë këtyre viteve? Në xhepat e qeverisë hajdute. Përderisa pensioni i punonjësve varet nga kontributi, edhe një muaj të kesh punuar, të takon ta marrësh atë, qoftë edhe dhjetë qindarka në muaj.

Përveç ca veprimeve elementare për nxjerrjen e çertifikatave, ajo platforma mizerabël e-Albania e reklamuar me aq fishkezzarre si fjala e fundit e teknologjisë elektronike nuk vlen për asgjë. Emigranti shqiptar ka vështirësi për të nxjerrë një kartë identiteti apo një pasaportë.

Asnjë institucion i asnjë qeverie shqiptare nuk ka bërë ndonjë studim të saktë për të përcaktuar se ku i ka

shtetasit shqiptarë. Nuk po flas as për folklorizma nacionaliste, etnicitete, plisa e xhubleta dhe hamendësime nacionaliste. Po flas për statistika mbi qytetarët që mbajnë nënshtetësi shqiptare. Ka vende në botë që nuk pranojnë dyshtetësi. Nëse një shqiptar në diasporë për një arsye apo një tjetër e ka lënë nënshtetësinë shqiptare, ai ose ajo nuk është më shtetas shqiptar. Pra, a ka të dhëna shteti shqiptar se ku dhe në ç'numër i ka shtetasit e vet në botë? A ka marrë mundimin të studiojë se cilat janë problemet e tyre aty ku janë? A i ka pyetur ndonjëherë se cilat janë nevojat e tyre në lidhje me Shqipërinë?

Zero. Vetëm i numërojnë si bagëtitë kur hyjnë e dalin në Shqipëri për pushime, sa për të fryrë statistikat e turistëve që vizitojnë vendin.

Natyrisht, faj kanë edhe ata shqiptarë emigrantë që bëhen prë e shqiponjës me dy koka Rama-Rama, ata që kujtojnë, ose i mbushin mendjen vetes dhe të tjerëve që po i shërbejnë atdheut, kur në fakt e lejojnë veten të milen si lopë nga diktatoruci i radhës. Unë nuk di kush e ka mbushur atë sallën e Pallatit të Kongreseve në Tiranë, por di të them që s'kam pikën e respektit për ta. Ata nuk më përfaqësojnë mua.

Sa për kokat e diktatorucëve që mbushin ekranet e mëdha, ata nuk e zëvendësojnë kurrë shqiponjën dykrenare. Ata nuk janë as koka e shqiponjës dhe as atdheu.

ATDHEU NUK JE TI

Dotech

websites 

UPGRADE YOUR WEBSITE

100%
Trusted

I jepni biznesit tuaj një faqe moderne, të shpejtë dhe të lehtë për t'u përdorur, e cila i shndërron vizitorët në klientë. Ne e ridizenjojmë, optimizojmë dhe përmirësojmë faqen tuaj për të rritur performancën, dukshmërinë dhe ndikimin.

Our Services

- ✓ Custom web design
- ✓ E-commerce setup
- ✓ Mobile optimization
- ✓ Website maintenance
- ✓ SEO structure

Build a website that works beautifully fast and converts visitors into customers.

NA KONTAKTONI

Adresa e zyrave:

30 Avenons Road London E13 8HT



020 7018 7929

073 4066 5946

078 5997 7545



IRENA BEQIRAJ

Një komb mund të dëshirojë rrëzimin e një diktatori, por jo mjaftueshëm njerëz janë të gatshëm të organizohen kundër autokracisë.

Një lagje kërkon rrugë më të sigurt, por askush nuk paraqitet kur duhet të mblidhen e të vendosin për të. Një komunitet profesional kërkon standarde më të larta, por secili pret që dikush tjetër t'i artikulojë ato. Edhe grevat më të mirë menduara shpesh dështojnë, sepse njerëzit dorëzohen shpejt, duke i bërë të tjerët të ndiejnë se përpjekja e tyre ishte e kotë.

Kjo zakonisht lexohet si dështim moral. Në të vërtetë, më shpesh është një dështim strukturor.

Në ekonominë politike, hendeku mes interesit kolektiv dhe gatishmërisë individuale për të vepruar është thelbësor për të kuptuar pse grupet dështojnë të organizohen. Veprimi kolektiv prodhon të mira të përbashkëta, jo përjashtuese, pra përfitime që nuk kufizohen vetëm te kontribuuesit. Përballë kësaj, individit racional arsyeton: nëse kontribuoj, përfitoj edhe të tjerët; nëse nuk kontribuoj, mund të përfitoj sërish. Prandaj, më mirë të përmbahem. Kur kjo logjikë përhapet, veprimi kolektiv paralizohet. Racionaliteti individual prodhon dështim publik.

Shoqëria shqiptare duket, në këtë kuptim, si një bashkësi individësh racionalë, dhe pikërisht për këtë arsye

BASHKËVEPRIMI KOLEKTIV, SHQIPTARËT RACIONALË EDHE MUNGESA E ELITËS INTELEKTUALE!

prodhon kaq shpesh rezultate irracionale. Edhe kur "racionaliteti" shndërrohet në justifikim për mosveprim, shoqëria ngec në një cikël të pafund diagnostikimi, pa asnjë përmirësim real.

Ndërkohë që veprimi kolektiv nuk lind thjesht nga vullneti i mirë; ai kërkon mekanizma të ndërtuar me kujdes.

Teksa flet më një mjek, profesor, inxhinier brenda apo jashtë Shqipërisë, është e dukshme që në Shqipëri, bashkëveprimi kolektiv gabimisht shihet si detyrë funksionale e partive politike. Në optikën e shqiptarit "racional" është detyrë vetëm e aktivistët politik sipërmarrja, e organizimit kolektiv. Në realitet, mekanizmat më të qëndrueshëm të bashkëveprimit ndërtohen nga elita intelektuale, jo domosdoshmërisht brenda politikës.

Siç shprehet Antonio Gramsci: "Të gjithë njerëzit janë intelektualë, por jo të gjithë kanë funksionin e intelektualit në shoqëri."

Kjo nuk është një tezë elitiste, por një thirrje politike. Intelektuali nuk është thjesht interpretues i botës; ai është formësues i kuptimit, drejtimit dhe koherencës shoqërore. Roli i tij është



të ndërtojë vetëdije, të sfidojë narrativat dominuese dhe të ndihmojë shoqërinë të kuptojë veten, duke u bërë kështu katalizator i bashkëveprimit kolektiv transformues.

Në kontekstin shqiptar, ky lloj intelektual është i rrallë. Ajo që haset më shpesh është figura e "intelektualit tradicional", reaktiv dhe jo parashikues, i pranishëm në reagim ndaj krizave, por jo në parandalimin e tyre.

Me fjalë të tjera, mungon një elitë intelektuale publike: një shtresë që sfidon pushtetin, që vë në dyshim supozimet e trashëguara dhe i ofron shoqërisë mënyra të reja për të parë veten, pa rënë në përsëritje historike. Mungojnë intelektualët që mendojnë seriozisht në publik dhe për publikun.

Kjo mungesë duhet të na shqetësojë, por jo të na habisë.

Fundja ajo pasqyron vlerat që vetë

shoqëria kultivon dhe shpërblen. Kur përparësi marrin qëllimet afatshkurtra mbi përgjegjësinë afatgjatë, kur sukcesi reduktohet në materializëm dhe status kur nocionet e detyrës dhe sakrificës relativizohen, krijohet terreni ideal për dominimin e racionalitetit oportunist, dhe, bashkë me të, të elitave intelektuale të dobëta.

Në këtë realitet, asnjë politikan "i urryer" i vjetër apo i ri nuk është devijim; ai është rezultat.

Kur qytetari mesatar kërkon rehati pa përgjegjësi dhe siguri pa angazhim, dallimi mes tij dhe përfaqësuesit politik është vetëm çështje e nivelit "të suksesit" brenda të njëjtin sistemi sjelljeje.

Të fajësosh pa pranuar bashkëfajësinë kulturore është e lehtë, por e pafytyrshme.

Ndryshimi real kërkon diçka më të thellë: rindërtimin e një sistemi vlerash të orientuar drejt së përbashkëtës. Pa një masë kritike që refuzon hiper-individualizmin sipërfaqësor dhe rikthen në qendër detyrën, përgjegjësinë dhe qëllimin e përbashkët, pushteti si do që ta këtë emrin, do të vazhdojë të pasqyrojë në një formë të zmadhuar atë që ne jemi.

LUAN RAMA

Përveçse krejt e pavend, më është dukur edhe e pakuptimtë këmbëngulja (le ta quajmë naive në sensin më pozitiv të fjalës) e Kryeministrit të Shqipërisë për t'u bërë garant apo dorëzan i pasurive të asaj zonje, që ka qenë drejtoreshë e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).

Them "asaj zonje që ka qenë", sepse ajo zonja nuk është më drejtoreshë. Tani ajo është e akuzuar nga SPAK-u. Tani ajo është marrë e pandehur si pjesëtare e një grupi të strukturuar kriminal. Tani ajo është edhe në arrest shtëpie.

Megjithatë, edhe pse e akuzuar zyrtarisht nga SPAK-u, edhe pse e marrë e pandehur si pjesëtare e një grupi të strukturuar kriminal, edhe pse në arrest shtëpie, Kryeministri i Shqipërisë zgjodhi t'i dalë në krah dhe të na thotë se gjithçka që ka bërë SPAK-u ndaj saj është kaq e padrejtë, sa ajo jo vetëm që është akuzuar kot, por e shkreta nuk paska as shtëpi të vetën dhe banoka në një shtëpi me qira.

Vërtet për t'ia qarë hallin! Dhe kur këtë e thotë, as më shumë e as më pak,

A E GËNJYEN, APO NA GËNJEU KRYEMINISTRI?

vetë Kryeministri i Shqipërisë, madje në mbljedhjen e një trupe të zgjedhur deputetësh e ministrash që e dëgjonin gojëhapur dhe tërësisht të mahnitur, nuk ka si të mos e besosh. Mirëpo historia nuk mbaron këtu.

Nga informacioni zyrtar i SPAK-ut lidhur me konfiskimin e pasurive të grupit të strukturuar kriminal të AKSHI-t, mësojmë se ish-drejtoresha, për të cilën Kryeministri i Shqipërisë vuri duart në zjarr dhe tha se nuk kishte as shtëpi ku të fuste kokën dhe se banon me qira, rezultojnë të ketë disa pasuri (apartamente në Tiranë e në bregdet, sipërfaqe me ullishta, disa llogari bankare etj.). Këtu lind një pyetje:

A duhej Kryeministri i Shqipërisë të fliste dhe të merrte përsipër t'i thoshte opinionit publik nëse ajo zonja kishte apo jo një shtëpi të veten?

Sepse çështja nuk është më thjesht nëse ai është informuar gabim apo nëse ka zgjedhur të thotë diçka të pavërtetë. Çështja është tjetërkund. Një Kryeministër nuk është komentues i lirë dhe asnjë qytetar i zakonshëm që ndan një mendim personal.

Ai është Kryeministri i Shqipërisë. Dhe si i tillë, çdo fjalë e tij ka peshë dhe vlerë institucionale. Kur ai thotë se një person "nuk ka shtëpi" apo "jeton me qira", ai nuk po shpreh thjesht një opinion. Ai po deklaron një fakt. Madje, po e deklaron atë me autoritetin e detyrës që mban.

Dhe këtu qëndron problemi i vërtetë. Sepse në momentin që një çështje është në duart e drejtësisë, në hetim nga SPAK-u, çdo përpjekje për të "garantuar" publikisht për një individ,

qoftë edhe në mënyrë retorike, krijon një përplasje të panevojshme dhe të rrezikshme. Nga njëra anë kemi institucionin që heton dhe sekuestron pasuri. Nga ana tjetër kemi Kryeministrin e Shqipërisë që jep garanci publike për të kundërtën e asaj që thotë SPAK-u. Në këtë pikë, publiku mbetet në një pozitë absurde: Kujt duhet t'i besojë?

Dhe kjo është pasoja më e madhe.

Sepse edhe në rastin më të mirë, nëse Kryeministri është thjesht i keqinformuar, kemi një problem serioz me mënyrën se si ai informohet për çështje kaq të ndjeshme.

Por në rastin tjetër, nëse ai ka folur duke e ditur realitetin, atëherë kemi një problem edhe më të rëndë: përdorimin e autoritetit për të ndërtuar

një "të vërtetë" të veten që nuk përputhet me faktet. Megjithatë, përtej këtyre dy skenarëve, mbetet një e vërtetë e thjeshtë: Kryeministri i Shqipërisë nuk duhet të jetë garant i askujt përpara drejtësisë. Sepse në momentin që e bën këtë, ai nuk po mbron më thjesht një individ. Ai po cenon kufirin që duhet të ekzistojë mes pushtetit politik dhe drejtësisë. Dhe kur ky kufi preket e kalohet, dëmi nuk është më individual. Është institucional. Prandaj pyetja: "A e gënjen, apo na gënjeu Kryeministri i Shqipërisë?" ka nevojë për përgjigje. Por ndoshta kjo nuk është më pyetja më e rëndësishme.

Pyetja më e rëndësishme është: Pse një kryeministër merr përsipër të flasë si garant për një çështje që duhet t'i përkasë vetëm drejtësisë?

PËR PUNËT E SHQIPËRISË



DITMIR BUSHATI

Procesi i anëtarësimit të Shqipërisë në BE po mbulohet nga mjegulla e një debati që nuk i shërben askujt. Opinioni publik po orientohet rreth miratimit ose jo të Raportit për Piketat e Ndërmjetme të Komisionit Europian (IBAR) në fushën e sundimit të së drejtës.

Që në pikënisje procesi i bisedimeve ka vuajtur nga mungesa e transparencës, konsultimit dhe llogaridhënies.

Ndërsa BE-ja e ka bërë publik pozicionin negociues me Shqipërinë për të gjithë grupkapitujt, sikundër piketat e ndërmjetme që duhen përmbushur në lidhje me sundimin e së drejtës, pozicioni negociues i Shqipërisë është mbajtur konfidencial, duke mos i dhënë mundësi Kuvendit, shoqërisë civile, medias, akademikëve dhe sipërmarrjes që të jenë realisht pjesë e këtij procesi.

Sot jemi në një situatë paradoksale, ku nga njëra flitet për 'kutiza të plotësuar' e '92 hendeqe të mbushura', për 'besimin që kemi fituar nga ana e Komisionit Europian', e madje se 'Komisioni flet me vendet anëtare të BE-së në emrin tonë'; dhe nga ana tjetër, flitet për 'bllokim të procesit', duke u bërë zëdhënës të shqetësimeve të vendeve anëtare të BE-së. Për të perifrastuar psikologun e famshëm amerikan Herbert Simon, ky lloj informacioni krijon varfëri të vëmendjes.

Në mes të procesit të bisedimeve për anëtarësim në BE ka nisur edhe një fushatë informimi. Mirëpo, askush nuk po merr mundimin të shpjegojë se si standardet europiane po përkthehen në mirëqeverisje e progres shoqëror.

Përkundrazi, komentohet ndërveprimi mes Komisionit dhe vendeve anëtare

të BE-së, sikur të ishim spektatorë dhe jo protagonistë të fatit tonë.

Ndërveprim, që ka ndodhur edhe në të shkuarën për nisjen dhe përfundimin e bisedimeve për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit; për rekomandimin për statusin e vendit kandidat; për nisjen e bisedimeve për anëtarësim në BE.

Flitet në emër të Komisionit apo vendeve anëtare të BE-së, në mungesë të një analize të vërtetë për sfidat e panumërta që kemi përpara. Nuk ka asnjë diskutim se si e përmes cilave reforma do të bëhet Shqipëria një shtet modern europian në kuptimin e sundimit të së drejtës dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik e shoqëror.

Jemi rifutur në rrethrotullimin e akuzave të ndërsjella politike duke shfaqur mungesë kapaciteti korrigjues për vonesat që në shumë raste i shkaktojmë vetë. Edhe sot, kur për shkak të gjeopolitikës, dera e anëtarësimit në BE është hapur, e kemi të vështirë të kuptojmë se në këtë proces qeveritë kanë barrën kryesore, por përgjegjësia e klasës politike është e përbashkët.

Ndërsa merita është vetëm e shqiptarëve që nuk kanë asnjë mëdyshje për rrugën europiane.

Në vend që të flasim për kapituj, kutiza, hendeqe, masa, apo ta përshkruajmë BE-në si një ndërtesë dykatëshe, ku në katin e parë vendos Komisioni e në katin e dytë vendosin vendet anëtare, dhe jo siç parasheh traktati i saj, na duhet një debat i vërtetë se si përmes ushtrimit të këtij procesi shtetkonsolidues do të garantojmë garën në jetën publike; integritetin e jetës politike; se si do të luftojmë metastazat e korrupsionit e krimin të organizuar në jetën publike dhe në sektorët kritikë të ekonomisë; se si do t'i japim fund modeleve të pandëshkueshmërisë; se si do të ndërtojmë një administratë mbështetur te merita e në shërbim të publikut; se si do të garantojmë autonomi e të zgjed-

hurve vendor, decentralizimin e kompetencave dhe shërbimeve për të forcuar kohezionin e komuniteteve; se kur shkollat tona do të jenë vatra të dijes dhe pjesë e rrjeteve të kërkimit europian; se si do të frenojmë ritmin e lartë të emigrimit dhe kur do të flasim për rritjen e popullsisë; se kur sipërmarrësit tanë do ta masin suksesin në bazë të riskut të marrë apo inovacionit dhe jo vetëm përmes tenderave të buxhetit të shtetit; se kur punëtorët do të ndjehen të shpërblyer për kontributin e tyre në zhvillimin

ekonomik; se kur do të garantojmë shenjtëria e pronës; se si do ta çlirojmë garën në ekonomi për çdo lekë që del nga buxheti i shtetit apo euro që vjen nga BE-së, duke zbatuar rregullat e prokurimit publik dhe konkurrencës së ndershme; se kur do të garantojmë cilësinë e ushqimeve që hamë; se kur do t'i japim kapitalizmit një fytyrë sociale duke rritur bazën e mirëqenies e ndarë në mënyrë të drejtë burimet dhe pasurinë e përbashkët; dhe kur do të flasim për një ekonomi që bazohet tek dija.

Natyrisht, lista e mësipërme nuk është shterruese. Por, ilustrim i faktit se pritshmëritë e njerëzve nuk mund të

"ushqehen" me kapituj. Me pak fjalë, duhet të jemi në gjendje të ndërlihim progresin në letër me realitetin e përditshëm.

Debati duhet të përqendrohet tek mbrojtja e interesit të ekonomisë dhe shoqërisë shqiptare, tek sektorët që mund të kenë avantazh krahasues me ekonominë e tjera. Të gjitha grupet shoqërore duhet të kyçen në këtë proces.

Debati duhet të jetë për cilësinë dhe shpejtësinë e procesit të anëtarësimit në BE. Për standardin e jetës së përditshme. Për punët e Shqipërisë.



THE BIG

MAY BANK HOLIDAY

WEEKEND FAIR

THIS IS A TOKEN OR WRISTBAND FAIR

THURSDAY

30

APRIL

TO

MONDAY

4

MAY

CARD & CASH ACCEPTED



Dont Miss This Great Family Value

£14.99

PER PERSON PER SESSION

OPENING TIMES:

WEEKDAYS 3PM-EARLY EVE

WEEKENDS 11.30AM-EARLY EVE

AND ENJOY UNLIMITED FREE RIDES

Don't Miss **PUNCH & JUDY** & **DINO INVASION!**

Every Weekend

VICTORIA PARK & DINO INVASION!

FINCHLEY N3 2PY

HOTLINE 07956 245531

www.parnhamfunfairs.co.uk

POROSISNI BANNER PËR BIZNESIN TUAJ



**PVC BANNERS
MESH BANNERS
PREMIUM ROLLER
PULL UP ROLLER**



Na kontaktoni:

020 7018 7929

073 4066 5946

078 5997 7545

ARBEN MALAJ

Robert Shiller¹ nobelist në ekonomi konkludon se: “Algoritmet grabitqare janë projektuar për të gjetur pikën e dobët të psikologjisë njerëzore, që të gllabërojnë kursimet para se rregullatorët të kuptojnë çfarë ndodhi”.

Prof. Nouriel Roubini², i njohur për parashikimin e krizës globale të vitit 2008 thekson se: “Inteligjenca Artificiale në financë është një thikë me dy tehe: ajo mund të rrisë eficiencën, por në duart e ‘peshkaqenëve’ kthehet në një mjet për të manipuluar sjelljen njerëzore dhe për të fshehur rreziqet sistemike nëpërmjet algoritmeve grabitëse”. Fitimet e larta dhe të shpejta shërbejnë si një “karrem” digjital i parazistueshëm. Shqetësimi ynë rritet sepse në tregjet financiare po përjetojnë një paradoks të rrezikshëm: ndërsa inovacioni premtan demokratizim të investimeve, ai po mpreh dhëmbët e një specijeje të re grabitqare që operon në hije.

Sot, “peshkaqenët” e tregut nuk fshihen më pas kontratave me shkrim të imët apo zyrave luksoze, por pas algoritmeve të sofistikuar dhe Inteligjencës Artificiale (IA) që gllabërojnë me shpejtësi marramendëse kursimet e qytetarëve pa njohuri për investimet euforike.

Në këtë realitet të ri, rreziku është rritur në mënyrë eksponenciale sepse IA po keq përdoret për të krijuar:

- (i) asimetri informacioni;
- (ii) (për të shfrytëzuar mungesën e theksuar e edukimit financiarë dhe +
- (iii) për të shfrytëzuar dobësitë tona psikologjike.

Dimensioni i këtij mashtrimi është tashmë një pandemi financiare globale me shifra tronditëse. Rreth 1.6 trilionë dollarë humbasin çdo vit nga mashtrimet financiare në rang botëror.

Këto nuk janë thjesht statistika; ato përfaqësojnë djersën dhe mundin e miliona familjeve. Humbja mesatare për një individ në këto skema luhetat nga 10,000 deri në 50,000 dollarë, shifra që shpesh përfaqësojnë kursimet e një jete të tërë.

Kostoja më e rëndë mbeten kostot psikologjike “post trauma”. Studimet tregojnë se deri në 70% e viktimave pësojnë trauma të rënda psikologjike, ankth kronik dhe depresion.

“Peshkaqenët financiarë” nuk vjedhin vetëm para, por shkatërrojnë jetë. Për ne shqiptarët, ky rrezik mbart një hije të rëndë historike që nuk duhet haruar kurrë. Tragjedia e vitit 1997 mbetet rasti më i madh dhe më tragjik botëror, kur mbikëqyrja dështon dhe lakmia ushqehet nga padija.

Me 50% të GDP-së, 60% të popullsisë të prekur dhe gati 3,000 jetë të



humbura, ky rast duhet të shërbejë si një paralajmëruar në përhershëm dhe në çdo vend, të pazhvilluar, por edhe për çdo vend të zhvilluar.

Sot, algoritmi është “fjala e dhënë” e djeshme, por me fuqinë e Inteligjencës Artificiale për të identifikuar flluskat financiare përpara se rregullatorët të reagojnë.

Në këtë betejë midis teknologjisë gllabëruese dhe mbrojtjes së konsumatorit, roli i autoriteteve mbikëqyrëse është jetik.

Mbikëqyrja duhet të jetë: (i) profesionale; (ii) proaktive dhe (iii) mbi të gjitha e pakorruptueshme. Nuk mjafton më vetëm kontrolli i bankave tradicionale; duhet të aplikohet një standard i ri i “transparencës së algoritmeve”. Çdo platformë investimi, fond kredie private apo entitet i “Shadow Banking” që kërkon tërheqjen e kapitalit publik, duhet të mbikëqyret hap pas hapi dhe në kohë reale, me efekte të qarta parandaluese nga të gjitha institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e tregjeve financiare

dhe bankare, në mënyrë të koordinuar.

Këtu përfshihen: Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Autoriteti i Inteligjencës Financiare, Shërbimi Informativ Shtetëror (me fokus të sigurisë kombëtare nga mashtrimet financiare), si dhe Policia e Shtetit përmes strukturave të luftës kundër krimit ekonomik dhe mashtrimeve financiare.

Numri viktimave mund të reduktohet sado pak edhe nga respektimi i disa këshillave praktike bazuar nga historitë e dhimbshme ndërkombëtare ku bënë pjesa edhe vendi ynë.

E para, përpara se të transferoni kursimet tuaja në çdo platformë apo fond investimi, këshillohuni edhe me këto filtra sigurie si:

(i) A është kompania e regjistruar dhe i licencuar nga Banka e Shqipërisë ose Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;

(ii) Nëse fitimi duket i garantuar dhe ndjeshëm më i lartë se tregu, është

pothuajse gjithmonë një skemë mashtruese;

(iii) kur përgjigjja është se “algoritme sekrete”, “tregti komplekse me kriptë” ose “metoda që nuk mund t’i kuptojë çdokush”, ky është një alarm i kuq se po ju vjedhin.

E dyta – Mashtruesit digjital shpesh përdorin “periudha bllokimi” për të mbajtur kapitalin brenda skemës për aq kohë sa u duhet për t’u zhdukur. Ikni nga platformat që ekzistojnë vetëm në “WhatsApp”, “Telegram” apo në një adresë “offshore” në ishuj të largët.

E treta – A po ju shtyjnë të investoni “tani ose kurrë” sepse mundësia do të mbyllet? Mashtruesit përdorin urgjencën për t’ju penguar të mendoni në mënyrë racionale. Këshillohet që për çdo ofertë tunduese, prisni 48 orë përpara se të investoni.

E katërta – Nëse ju kërkohet të sillni miq për të rritur shpërblimin, skema mashtruese do të falimentojë. Bëni kujdes nga dëshmitë e rreme pozitive sepse ato shpesh krijohen nga vetë al-

goritmet. Sot 2/3 e kodimit nuk bëhen më nga koduesit, por nga vetë inteligjenca artificiale.

E pesta – Çdo investim duhet të shoqërohet me një kontratë të detajuar ku shpjegohen rreziqet dhe nëse ndjeheni të pasigurt është më mirë të humbni një “oportunitet” sesa të humbni kursimet e një jete. Nuk duhet t’i besoni një personi real apo digjital, të cilët nuk kanë asnjë garanci për paratë që ju besoni dhe ata ju vjedhin.

Raghuram Rajan³ thekson se: “Rreziku më i madh i epokës sonë është përdorimi i saj për të krijuar asimetri informacioni ku peshkaqenët shohin gjithçka, ndërsa investitorët e vegjël janë të verbër”.

Prandaj mbrojtja më e mirë dhe më e lirë mbetet edukimi financiar i qytetarit.

Ne duhet të kultivojmë një dyshim racional: fitimi i lartë pa rrezik është një mit digjital që nuk ekziston.

Mbikëqyrja e specializuar kundër “peshkaqenëve grabitqarë” duhet të fillojë nga detyrimi i tyre për të bërë lehtësisht të mbikëqyrshme algoritmet e tyre.

Është njësoj siç i kërkojmë çdo kompanie në ekonominë reale të depozitohet në dogana dhe tatime skemën teknologjike të prodhimit, për të lehtësuar kontrollin e shpejtë dhe parandaluar abuzimet.

Algoritmet e marketingut digjital të çdo kompanie duhen bërë transparente. Inteligjenca Artificiale nuk duhet lejuar të kthehet në një mjet gllabërimi, por duhet të vihet në shërbim të transparencës dhe sigurisë. Edukimi financiar parandalues është mbrojtja jonë e vetme në një “oqean financiarë”: më të madh, më të thellë të mbushur me “peshkaqenë” digjitalë, kafshimet e të cilëve janë të dhimbshme deri në mbijetesë.

¹ Robert J. Shiller është një ekonomist fitues i Çmimit Nobel, profesor në Universitetin Yale dhe autor i njohur për analizat e tij mbi paqëndrueshmërinë e tregjeve financiare.

² Nouriel Roubini (Dr. Mallkimi) është një nga ekonomistët më të njohur në botë. Ai fitoi famë ndërkombëtare kur në vitin 2006 paralajmëroi FMN për krizën e 2008

³ Raghuram Rajan është ekonomist i shquar indian, profesor në Chicago Booth dhe ish-Gubernurator i Bankës Qendrore të Indisë, i njohur botërisht për parashikimin e krizës financiare të vitit 2008

ANDI MUSTAJ

Është një nga pyetjet më të shpeshta që u bëhet politikanëve dhe që merr një prej përgjigjeve më të shpejta prej tyre, gati instiktive, nga ato që në fakt tregojnë një mungesë të thellë mendimi.

Jo – thonë të gjithë – nuk ka meritokraci në politikën shqiptare. Me bindje, me emra, jepen shembuj njerëzish të ditur që janë anashkaluar, njerëz me vlera që janë harruar. Përballë jepen emra të cilët, sipas tyre, nuk e meritojnë promovimin e tyre politik.

Deri dje, deri diku edhe unë mendoja se në politikën shqiptare nuk ka meritokraci. Pastaj u njoha me librin e Pëllumb Nakos, “Indi Social i Shqipërisë”, leximin e të cilit ia këshilloj çdo personi që kërkon të kuptojë fenomenet që përshkojnë shoqërinë tonë.

Ndër vite jam munduar të zhvilloj idenë se në Shqipëri ekziston një hendek midis shtetit formal dhe shtetit real, shtetit në letrat zyrtare dhe atij brenda të cilit ne jetojmë. Këtë dallim e kisha analizuar duke u nisur nga pasojat e sistemit komunist në shoqërinë tonë dhe në veçanti në marrëdhënien që kjo e fundit ushqen me shtetin apo administratën.

Pëllumb Nako e ka çuar analizën shumë më larg duke zhvilluar një teori të plotë, që shpjegon ndërveprimin e trupit social me gjënë publike dhe me atë private. Ai e ndjek rrënjën nëpër çdo sistem politik që ka

A KA MERITOKRACI NË POLITIKËN SHQIPTARE?



prekur Shqipërinë, deri tek Perandoria Osmane dhe marrëdhënia e saj me të drejtën zakonore, me prevalencën e marrëdhënies private për të rregulluar atë që në fakt duhet të ishin çështje publike të përbashkëta. Gati në çdo kohë, vendi ynë ka njohur një sistem dual: dy sisteme vlerësimi që jetojnë bashkë, shpesh pa e ditur njëri për tjetrin.

Kjo teori ndihmon, e vetme, për të kuptuar dhe shpjeguar një numër të madh keqfunksionimesh dhe keqkuptimesh që ekzistojnë sot në Shqipëri. Një prej tyre është pikërisht keqkuptimi mbi ekzistencën apo jo të meritokracisë në politikën shqiptare.

Kur pyetet “a ka meritokraci?”, pyetjes i jepet automatikisht kuptimi që shteti i shtyrë nga presioni i mime-

tizmit me perëndimin, është munduar të imponojë nëpërmjet ligjeve dhe akteve të tjera publike: ngjitja hierarkike mbi bazën e arritjeve profesionale, akademike, teknike. Ky është përkufizimi i Shqipërisë formale.

Sigurisht, kur pyetja shtrohet në një rrafsh, atë të Shqipërisë formale, dhe përgjigjet në një tjetër, atë të Shqipërisë reale, përgjigja e vetme është krijimi dhe ushqimi i një keqkuptimi të përhershëm.

Në Shqipërinë reale, siç e ka përkthuar në mënyrë të shkëlqyer Pëllumb Nako, të frymëzuar thellë nga e drejta zakonore, nga funksionimi klanik, nga prevalenca shekullore e marrëdhënies private mbi ato publike, merita njihet. Por njihet me kriterë të tjera.

Sistemi i vlerësimit nuk është i njëjtë. Ajo që një person duhet të tregojë që të vlerësohet dhe të meritojë njohjen nëpërmjet promovimit është besnikëria ndaj një apo disa personave, sakrifica për familjen e vet, mos vënia në dyshim e piramidës hierarkike, zbatimi i urdhrave. Është sistem i qëndrueshëm, i trashëguar, i internalizuar gjatë shekujve.

Pra, përgjigja e vërtetë është një paradoks: në politikën shqiptare ka meritokraci të plotë, por përkufizimi i meritokracisë krijon një thyerje midis asaj që duam të jetë dhe asaj që është në të vërtetë.

Merita nuk matet me diplomë apo ekspertizë, matet me besnikëri dhe angazhim. Kur dikush ankohet se “promovuan të paditurin”, ai në fakt po thotë: “Sistemi i vlerësimit që po zbatohet nuk është ai që unë mendoj se duhet zbatuar”. Dhe ka të drejtë, por duhet ta emërtojë saktë.

Këtë emërtim të saktë, sot shumica e qytetarëve e kanë të pamundur sepse ky vlerësim ndodh në subkoshencën e tyre. Njerëzit nuk zgjedhin me vetëdije të vlerësojnë besnikërinë ndaj një personi mbi kompetencën apo besnikërinë ndaj një kauze. Thjesht e bëjnë, sepse sistemi i brendshëm i vlerave ka rrënjë shumë më të thella se çdo ligj i shkruar pas vitit 1991.

Edhe ata që ankojnë mungesën e meritokracisë, nuk e kuptojnë se vendimarrja e tyre zbaton pikërisht atë sistem që kritikojnë te të tjerët.

Çfarë duhet bërë? Puna e parë dhe më e vështira është ndërgjegjësimi. Duhet ta kuptojmë dhe ta emërtojmë realitetin ashtu siç është, pa turp dhe pa iluzione. Pastaj duhet të punojmë për të njehsuar në mënyrë progresive përkufizimin e meritokracisë, duke zhvendosur forcën e rëndësës nga Shqipëria reale drejt asaj formale.

Meritokracia në politikë duhet të matet, së pari, sidomos në kushtet e regjimit autokratik në të cilin ndodhemi nga aftësia për të fituar mbështetje popullore, për të lexuar terrenin, për të bindur dhe mobilizuar.

Kjo qasje duhet të shoqërohet me një ndarje efektive të burimeve njerëzore: funksionari i shkëlqyer të jetë drejtor i përgjithshëm, jo kandidat për deputet; besnikëria e thellë të shpërblehet me role të brendshme, jo me platformë publike; secili në vendin ku “merita” e tij, me çfarëdo kuptimi, prodhon më shumë.

Kjo është një nga detyrat më të vështira që na pret në ndërtimin e një strukture fituese: të mësojmë të flasim gjuhën e Shqipërisë reale, ndërkohe që punojmë pa pushim për të ndërtuar Shqipërinë formale.

Dotech website

“ AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE PËR BIZNESIN TUAJ? ”

Akoma nuk jeni regjistruar në Google?

Adresa e zyrave:

30 Avenons Road London E13 8HT



Tel: 020 7018 7929



Mob: 073 4066 5946



Mob: 078 5997 7545



The Albanian

KRIJO WEBSITIN TËND

MOS RRI ANONIM

Me mijera klientë mund të jenë të intersuar për biznesin tuaj, por mbase nuk e dijnë që ti ekziston...



JEPI
FRYMEMARRJE
BIZNESIT TËND

Për çdo konsultim mund
të vini në zyrat tona

Adresa e zyrave:
30 Avenons Road
London E13 8HT

Dotech
websites

☎ 020 7018 7929

☎ 078 5997 7545

☎ 073 4066 5946

Një ndër sfidat kryesore të Kosovës është gara e vazhdueshme për kujtesë: çka është ajo që duam të mbajmë mend? Zgjidhja mund të kërkohet në hapësirën evidente, siç është ideja e Ditës së Lirisë, si një ndër opsionet e mundshme.

VETON SURROI

1.

Çka kanë të përbashkët piramidat e Gizës, shënimi i një masakre në akëcilin vend të Kosovës dhe një ditë në Holandë ku të gjithë qytetarët ndalen për dy minuta në heshtje?

Që të tria janë pjesë të asaj që dr. Jan Assmann përshkroi për herë të parë si “kulturë kujtese”. Dr. Assmann arriti këtë formulim, si egjiptolog që është, duke konstatuar se piramidat në Egjipt u ndërtuan për mbamendje. Faraonët i përkisnin një kulture e cila kishte konstatuar se objektet që shënojnë vdekjen dhe rrëfimet brenda tyre (hieroglifët, objektet artistike dhe ushqimi që përcjellin të vdekurin në botën tjetër) japin jetë pas vdekjes. Vdekja që mbetet e pashënuar përfundon me kaq.

Dhe kultura e kujtesës si koncept pastaj shpërndahet gjithandej, megjithëse format e saj ndryshojnë ndjeshëm nga një shoqëri në tjetër dhe nuk ndjekin gjithmonë të njëjtin model zhvillimi, transformohet në rrëfime e mite, monumente e shtatore, madje në fund, sikur në Holandë, në dy minuta heshtje të të gjithë qytetarëve të vendit, të ndalur kudo t'i ketë zënë sirena kundërajrore që lajmëron fillimin e ritualit. Më 4 maj—dhe më ka rastisur të jem aty në një datë si kjo—i tërë vendi ndalet për të shënuar viktimat e Luftës së Dytë Botërore, ushtarë e civilë.

Dr. Jan Assmann do ta quante këtë moment, kur koha prej dy minutash bëhet arkitekturë, shenjtërim i kujtesës dhe po aq me rëndësi, shndërrim të tërë popullatës së vendit në “komunitet të kujtesës”. Kjo është njëra prej pikave më të larta të mundshme të identitetit kolektiv, e arritur në kushte të caktuara historike dhe institucionale, një pikë ngjizëse për një shoqëri që kalon edhe nëpër një transformim multikulturor.

2.

Shënimet e masakrave në Kosovë janë pjesë të një procesi që ende nuk është plotësisht kulturë kujtese, ndonëse përmban elemente të saj në zhvillim. Ditë pas dite shënohen ngjarjet e tmerrshme në njërin e pastaj tjetrin lokalitet; del njëri e pastaj tjetri rrëfim i viktimave. Në ditët kur nuk ka shënime të ditëve të masakrave, ka shënime të sheqerave të luftërave; që të gjitha të shpërndara, çdonjëra me një

rrëfim të vetin.

Në studimet e kujtesës, Kosova paraqet rastin e një vendi në tranzicion kujtese, një fazë që në vetvete nuk është e pazakontë dhe mund të shihet edhe si hap i ndërmjetëm drejt konsolidimit të saj, e që ballafaqohet paralelisht me së paku dy sfida.

E para është “kujtesa komunikative”, pra si shoqëri me një pjesë të madhe të popullatës që mban mend ngjarjet e tridhjetë vjetëve të fundit, ende është kujtesë e cila përflitet në përditshmëri—ende nuk është kujtesë e pranuar a njohur nga të gjithë. Dhe së dyti, jetojmë në garë ngjarjesh e kujtimesh, e cila ndonjëherë mund të reflektojë edhe pluralitetin e përvojave historike dhe sociale: çdo masakër, çdo betejë, çdo personazh është në garë për vëmendje publike. Jo rrallë, kjo garë merr edhe konotacion politik.

Ka shumë përkujtime. Ka shumë vizita, fjalime, vendosje kurorash dhe përvjetorë. Vetë rrjedha e lajmeve protokollare të përditshme tregon se sa dendur është i mbushur kalendari me akte përkujtime. Por dendësia e përkujtimit nuk prodhon domosdoshmërisht kujtesë kulturore të thellë, megjithëse ka vlerë të rëndësishme për komunitetet lokale dhe familjare. Ndonjëherë prodhon të kundërtën: shumëzim rituale pa integrim konceptual.

Kështu, ekziston rreziku që të bëhemi pengje të një rituali i cili nuk arrin të kalojë në stad tjetër.

LIRIA KA EMRA



Me fjalë të tjera, Kosova kujton shumë, por nuk u ka dhënë ende përgjigje të plota pyetjeve:

Cili është parimi renditës i përkujtimit?

Cilat data janë lokale, cilat komunale, cilat kombëtare dhe cilat qytetare-kushtetuese?

Cila është marrëdhënia ndërmjet martirizimit, viktimave civile, personave të zhdukur, dhunës seksuale, rezistencës paqësore e të padhunshme si dhe asaj të armatosur, çlirimit dhe shtetësisë?

Cila është marrëdhënia ndërmjet përkujtimit dhe bashkësisë politike të së ardhmes?

Kush e përcakton rendin e kujtesës dhe me çfarë legjitimiteti institucional e shoqëror?

3.

Mbase kjo pyetje e fundit, e ndërlikohet të kujtesës dhe bashkësisë politike, gjegjësisht identitetit shtetëror, është ajo që e pret Kosovën për të bërë hapin vendimtar që e bëri Holanda (apo Izraeli, Franca, Britania e Madhe, Gjermania e kështu me radhë). E ky hap mund të jetë identifikimi i një dite, i një momenti, i një ideje që përmbledh tërë atë kujtesë të shpërndarë ditë pas dite duke mos arritur momentin e ngjizjes.

Në garën mes datave të ndryshme historike, nuk shoh një datë që mund të përmbledhë më shumë integrim kujtese se sa dita e lirisë, më 12 qershor

të vitit 1999, megjithëse për disa grupe data të tjera mund të kenë peshë të krahasueshme simbolike. Atë ditë, me hyrjen e forcave të NATO-s u arrit fitorja për ta ruajtur Kosovën dhe popullin e saj, tërësinë tokësore të vendit, mundësinë e kthimit të të dëbuarve, krijimin e kushteve për një proces demokratik e paqësor për rindërtim të vendit e për vetëvendosje. Që të gjitha këto me përkrahje historike të Perëndimit, e në masë të madhe me përkrahje të OKB-së. Kthesa ekzistenciale e Kosovës simbolizohet në masë të madhe me këtë ditë, si kulm i një procesi më të gjatë historik.

Dhe, në këtë ditë Kosova mund të synojë të përbashkojë një pjesë të madhe të kujtesës së saj, duke qenë e vetëdijshme për kufijtë e një përfshirjeje të plotë. I tërë vendi mund të krijojë momentin e vet sakral, të atij dyminutëshit kur mbajmë mend rrugën e gjatë për liri. Në të njëjtën ditë, atë të lirisë, nuk do të duhej të ndaheshin dr. Fehmi Agani, Adem Jashari e familja e tij, familjet e vrara në Likoshan, Qirez, Mejë e cilëndo masakër tjetër të Kosovës, Agim Ramadani e Salih Çekaj, Zahir Pajaziti e Mujë Krasniqi. Në të njëjtën ditë kur të vihen lulet te varri i Ibrahim Rugovës, do të përkujtonim minatorët e Trepçës dhe marshin e tyre paqësor e grevën e tyre të urisë. Në të njëjtën ditë kur do të përkujtonim delegatët e 2 korrikut do të përkujtonim edhe ata që sollën Kushtetutën e vitit 1974.

Në atë ditë, jashtë historisë e përkujtimit nuk do të mbeteshin mësuesit

dhe çdo shkollë në çdo skaj të Kosovës dhe çdo gjuhe të saj; ata që nxorën një popull analfabet në dritë. Kjo ditë është e mjekëve dhe e profesorëve, inxhinierëve e profesionistëve të tjerë, është e Universitetit, e të burgosurve politikë, e gazetarëve, aktorëve të teatrit, këngëve të Nexhmije Pagarushës, poezive të Sat Nokshiqit e shokëve të tij. Megjithatë, integrimi i të gjitha këtyre përvojave në një narrativë të vetme kërkon një shkallë të lartë konsensusi shoqëror që mund të jetë ende në ndërtim.

Megjithëse ndërtimi i një kulture të përbashkët kujtese është një proces afatgjatë që kërkon jo vetëm simbole dhe data, por edhe institucione, arsim dhe praktikë të qëndrueshme publike, propozimi për një datë mund të shihet si ftesë për debat të mëtejshëm shoqëror.

Në atë debat propozoj që kujtesa e 12 qershorit të shihet si kujtesa e një populli në proces të mbërritjes drejt një identiteti më të plotë si bashkësi politike.

4.

Kosova më 12 qershor mund të konsiderojë bashkimin rreth lirisë si një projekt të përbashkët, atë të ndërtuar nga bijtë e saj gjeneratë pas gjenerate e të përkrahur me vendosmërinë e çlirimit nga demokracitë perëndimore të përfaqësuara me NATO-n.

Liria e cila synon ta bashkojë Kosovën ka emra.

MEHMET PRISHTINA

Sesioni i dytë, nr. 8 (19), 15 janar 1919,
SHQIPËRIA, revistë dymujore për mbrojtjen e interesave shqiptarë
Çmimi i numrit: 15 qindarka
Adresa: Fahu. P.nr. 17393, Lozanë,
stacioni hekurudhor
Një zë nga Shqipëria

Jemi të lumtur që sot para miqve tanë, por edhe para lexuesve dashamirës të Shqipërisë, mund të prezantojmë këtë dokument, i cili ka për qëllim të vëre gjërat në vendin të vet, të bindë ata mes nesh, besimi i mirë i të cilëve është shfrytëzuar nga intrigantë cinikë, si edhe të përgënjeshtrojë e të demaskojë ata të mjerë që, duke iu bindur interesave të ulët materialë, me vetëdije kanë kryer veprime, të cilat janë shumë afër kufirit të asaj që mendohet se është tradhti. Në thirrjen e fuqishme fisnike dhe patriotike që do të lexoni këtu, do të dëgjoni se si kumbon zëri i popullit shqiptar, i cili për shekuj të tërë është i etur për liri dhe pavarësi.


Në kushtet e sotme, populli ynë nuk mund të gjente interpretues më besnik dhe më të vërtetë sesa grupi i patriotëve të mbledhur rreth z. Hasan bej Prishtinës, nënshkrues, në emër të tyre, të kërkesës drejtuar z. Ujllson. Dëshirat e vërteta dhe aspiratat legjitime të popullit shqiptar shpallen këtu dhe paraqiten qartë e pa asnjë mëdyshje, sepse këto dëshira dhe këto aspirata mbështeten, deri në hollësitë më të vogla, mbi të drejtat e patjetërsueshme dhe të pacenueshme të popujve, ashtu siç i proklamonte me aq vendosmëri dhe autoritet Presidenti Ujllson.

Ne ende e ndiejmë ndjenjën legjitime të sadsifikacionit patriotik, për faktin se sot kemi mundësi t'u ofrojmë atyre që kanë ende dyshime, dëshmi të pakundërshtueshme, ajo që kemi mbrojtur vazhdimisht në faqet e botimit tonë modest përputhet pikë për pikë me ndjenjat autentike dhe reale të popullit tonë, sepse çdo fjalë e z. Hasan bej Prishtinës vërteton qartësisht atë që ne, madje kohët e fundit shumë shpesh, kemi mundësi ta vërtetojmë përmes këtyre rreshtave, e kjo është: "Pavarësi e plotë për mbarë atdheun shqiptar".

Pas kësaj thirrjeje nuk është më e nevojshme të denoncohen veprimet kriminale antipatriotike të grupit të mjerë të nënshkruesve të Factum de Geneve, as edhe të stigmatizojmë përpjekjet e tyre të turpshme për t'u paraqitur si zëdhënës të besueshëm të ndjenjave të një populli, që prej dekadash nuk i njeh më si të tillë dhe me të cilët nuk i lidh më as lidhja me e vogël morale ose materiale.

Pikërisht ky qëndrim i bën të pavlefshme kërkesat që qeveria e z. Sonino vazhdon të marrë nga disa prej bashkatdhetarëve tanë, të cilët ajo i mban nën pushtetin e saj në Itali, madje edhe nga disa shqiptarë të

LETRA E HASAN PRISHTINËS DREJTUAR UDRO UJLLSON, BOTUAR NË GAZETËN "ALBANIA", 15 JANAR 1919



Shqipërisë, ku karabinierët së bashku me civilë të tjerë dhe agjentë ushtarakë në Romë i nxitin me kujdes dhe zell për t'u nënshtruar ndaj zgjedhës së huaj.

Këtu në vazhdim do të paraqesim fjalë për fjalë, kërkesën që është i dërguar, në emër të tij, zotit President Ujllson, në Paris, më 18 dhjetor të vitit 1918: Zoti President, Ju jeni duke u përgatitur që të merrni pjesë në kongresin që duhet të rikonstrukttojë Europën sipas parimeve të së drejtës së popujve për të vendosur vetë për fatin e tyre, parime për të cilat lavdia e të shënuarit në flamurin e njerëzimit ju takon juve.

Në këtë çast solemn, ne, përfaqësuesit e dy milion e gjysmë shqiptarëve, popullit më të vjetër të Gadishullit Ballkanik, ju drejtohem juve me lutje që t'i shqyrtoni dëshirat e popullit tonë për paanshmëri të plotë, gjë që ju dallon shumë nga të tjerët dhe të na mundësoni që këto dëshira t'i parashtrujmë në Konferencën e Paqes. Për shekuj të tërë, pavarësisht vështirësive të panumërta me të cilat është përballur dhe është detyruar të luftojë populli ynë, ai ka ruajtur gjuhën e vet, origjinalitetin e vet, traditat dhe zakonet e veta.

Pesë shekuj të plotë populli ynë me një rezistencë të fuqishme i kundërvu presionit otoman dhe, në fund, ia mori pushtetin turk të gjitha ato arritje të mëdha me rënien e tij në vitin 1912. Është e vërtetë që në takimin e ambasadorëve në Londër në vitin 1913 u krijua Shqipëria e Pavarur, por pjesa

më e madhe e shqiptarëve dhe e tokave shqiptare mbetën jashtë kufijve të këtij shteti. Prandaj, proklamimi juaj në lidhje me të drejtat e popujve, që të merrnin në dorë fatin e vet, populli shqiptar e priti si porosi të një shpëtimtari. Nuk dyshojmë se Ju, zoti President, së bashku me aleatët Tuaj të kombit shqiptar, do t'i mundësoni popullit shqiptar të njëjtat të drejta, siç i gëzojnë armenët, çekët, jugosllavët dhe kombet e tjera.

Kombi shqiptar, i cili dha aq shumë jetë njerëzore për realizimin e idealit të vet kombëtar, ideal për të cilin derdhi aq shumë gjak, mbetet i bindur se Ju dhe aleatët Tuaj do t'u jepni fund vuajtjeve në emër të së drejtës dhe barazisë.

Të bindur në këto premisa, ne Ju drejtohem me lutje, z. President, që të shfrytëzoni ndikimin tuaj gjatë kohës së bisedimeve në lidhje me ardhmërinë e Shqipërisë, që në Konferencën e Paqes të ftohet për pjesëmarrje edhe delegacioni i popullit shqiptar, që të paraqesë dhe të arsyetojë dëshirat dhe kërkesat e kombit shqiptar. Ju drejtohem, z. President, me respektin tonë të thellë.

Në emër të kombit shqiptar (nënshkruar) Hasan Bej Prishtina Do të ishte një përdhosje e vërtetë tentimi që të bëhet një krahasim i kësaj kërkesë patriotike dhe dinjitoze dhe të atij dokumenti servil të nënshkruar nga grupi i pikëlluar i Gjenevës, të udhëhequr nga nëntëdhjetëvjeçari Turkan Pasha.

Në vazhdim do të prezantojmë disa fjalë për personalitetin e z. Hasan bej Prishtinës, që të shfaqim më qartë dallimin e thellë mes atyre të nënshtruarve që nënshkruajnë dokumentin e përpiluar nga një agjent që kërkon përfitime për imperializmin të huaj, dhe patriotëve që luftojnë për shpëtimin e atdheut dhe popullit të vet. Bashkatdhetari ynë i shquar, i cili rrjedh nga familja Berisha, ka lindur para dyzet vjetësh në Vushtrri, qytezë e vogël që gjendet mes Prishtinës dhe Mitrovicës, në atë pjesë të Shqipërisë Veriore, të cilën Konferenca e Ambasadorëve në Londër, duke shkelur mbi të drejtat e patjetërsueshme të popujve dhe në kundërshtim flagrant me të gjitha normat e së drejtës dhe barazisë, pati dobësinë t'ia linte këtë pjesë Serbisë, këtij fëmije të lazdruar të carizmit rus.

Hasan Beu shumë herët është dalluar për patriotizmin e tij të zjarrtë dhe veprimtarinë e tij të dendur për çështjen shqiptare. Nuk u zbraps para asnjë sakrifice: shpeshherë, kur ishte e nevojshme, ai i ka paguar shpenzimet për të gjitha veprimtaritë patriotike nga xhepi i vet.

Në vitin 1909, kur në Elbasan u themelua Shkolla e parë Normale Kombëtare, z. Hasan bej Prishtina u kujdes që të dërgonte dhe mbështeste, me shpenzimet e tij, tridhjetë të rinj nga kjo krahinë, ku kishte lindur vetë.

Ai u zgjodh deputet nga rajoni i Prishtinës në parlamentin e parë turk. Hasan bej Prishtina me vetëdije u radhit në anën opozitës, kundër shovin-

istëve të fuqishëm të Komitetit të Bashkimit dhe Progresist, të cilëve ua kuptoi vizionet e verbra panturke. Gjatë verës së vitit 1912 ishte shumë aktiv në kryengritjen shqiptare, e cila lëkundti themelet e fuqisë turke në Europë.

Pas disfatës dhe tërheqjes së ushtrisë turke në Mitrovicë, Prishtinë (23 korrik 1912) dhe Kaçanik, si dhe pas çlirimit të të gjithë vendit, Hasan Beu së bashku me udhëheqësit e tjerë të shquar ishte në krye të ushtrisë prej 30 000 luftëtarësh shqiptarë, të cilët hynë në Shkup (në fillim të gushtit të vitit 1912), gjë që solli kapitullimin e ushtrisë xhonturke në Stamboll. Më pas Hasan Beu u bë ministër në qeverinë e përkohshme të Vlorës, ndërsa kur u krijua qeveria e rregullt në Durrës, ai ishte anëtar në kabinetin e ministrave.

Lufta e Parë Botërore e gjeti në Shqipëri, të cilën nuk dëshironte ta linte. I përndjekur nga serbët dhe malazezët, të cilët pushtuan vendin në vitin 1915, ai i shpëtoi vdekjes falë shokëve të tij të përkushtuar, të të cilët ishte strehuar.

Okupatorët e rinj të vendit tonë, pas dështimit të regjimit serb, nuk ishin aspak më të mirë kundrejt bashkëkombësit tonë të shquar, dhe patriotizmi i tij i flaktë mbeti arsyeja për dyshim dhe mosbesim tek ai.

Pas akuzave shpifëse, u arrestua, u burgos dhe për një kohë të gjatë nuk kishte asnjë lajm nga ai.

Madje për këtë arsye, kishte momente kur ishim tejet të shqetësuar, sepse sipas thashethemeve të ndryshme, bëhej fjalë për dënimin me vdekje të tij. Për fat të mirë, e vërteta dhe pafajësia e tij më në fund dolën në shesh dhe Hasan bej Prishtina u lirua.

Tashmë kishte mundësi që t'ia kush-tonte veprimtarinë e tij çështjes së shkollave kombëtare, duke inkurajuar çdo nismë fisnike dhe vrull bujar në këtë drejtim. Ngjarjet e fundit në Prishtinë e trazuan dhe mes shumë vështirësive arriti t'u shmangej kërtimeve dhe përndjekjeve të shërbimeve serbe.

Sapo doli jashtë rrezikut nga armiqët e përbetuar të popullit tonë, z. Hasan bej Prishtina nxiti t'i dërgonte presidenti Ujllson kërkesën patriotike që sapo lexuam.

Gazeta L'Albanie. 15 janar, viti 1919 Dok. nr. 1

Artikulli "Zëri i Shqipërisë" rreth fjalimit të Hasan Prishtinës drejtuar presidentit Udho Ujllson, botuar në gazetën "Albania". 15 janar 1919

RAFAEL FLOQI

Në Samitin e Diasporës në Tiranë, gjithçka dukej e kuruar me kujdes: skenografia, fjalimet, narrativat optimiste dhe një vizion i Shqipërisë, që pret me krahë hapur bijtë e saj të larguar.

Shkallët e jashtme të Pallatit të Kongreseve u veshën me tapet të kuq, ndërkohë që simboli i shqiptarëve dykrenarë në murin ballor mikpriste dhjetëra shqiptarë që jetojnë në vende të ndryshme të botës, të ftuar në aktivitetin e qeverisë të njohur si Samiti i Diasporës.

Ky është samiti i katërt që qeveria organizon në harkun kohor të dhjetë viteve, pa pasur një bilanc të qartë mbi përfshirjen reale të diasporës në zhvillimin e vendit. Përkundrazi, ajo që bie në sy është përsëritja e së njëjtës skenografi politike: shumë fjalë për kthimin, pak mekanizma për përfshirjen; shumë premtime për investime, pak siguri për investitorët; shumë emocione patriotike, por pak vullnet për të ndërtuar ura reale bashkëpunimi.

Samiti nisi me fjalën e Kryeministrit Edi Rama, i cili foli për “Paketën e Maleve”, për mundësi të reja investimi dhe për një Shqipëri që, sipas tij, është bërë magnet për zhvillim. U fol për votën e diasporës, për suksesin e reformave dhe për klimën e favorshme për kapitalin e emigrantëve. Por u shmang pyetja thelbësore: çfarë lloj zhvillimi i ofrohet Shqipërisë dhe diasporës? Zhvillim për kë, në ç’sektorë dhe me çfarë vizioni afatgjatë? Sepse, po të shihet me vëmendje, modeli i zhvillimit që promovon Rama duket se njihet vetëm një alfabet: asfaltin, fasadën, kullat, resortet dhe shkurt atë zhvillim që matet me beton, me karta propagandistike dhe me postime në rrjetet sociale.

Shqipëria paraqitet si një vend që ecën përpara, por ecja e saj duket se kufizohet në rrugë, aeroporte pa fluturime, projekte turistike sezonale dhe një ekonomi që nuk ndërton prodhim të qëndrueshëm. Dhe këtu lind pyetja më serioze: pse Shqipëria nuk investon në industri? Pse nuk investon në industri përpunuese? Pse nuk investon në industrinë petro-kimike? Pse një vend që nxjerr naftë nga nëntoka e vet vazhdon ta eksportojë atë si lëndë të parë bruto dhe më pas t’i blejë derivatet e saj me çmimet më të larta në rajon? Pse duhet që pasuria natyrore shqiptare të largohet e papërpunuar dhe t’i kthehet qytetarit shqiptar si barrë e shtrenjtë në pompë, në transport, në prodhim, në jetën e përditshme?

Kjo nuk është thjesht pyetje ekonomike. Është pyetje politike, strategjike dhe kombëtare. Një vend që eksporton naftë bruto dhe importon karburant të përpunuar me çmime të larta, në të vërtetë eksporton dobësinë e vet dhe importon varësinë e vet. Ai humbet vlerën e shtuar, humbet



vendet e punës, humbet dijen teknike, humbet mundësinë për të ndërtuar zinxhir industrial dhe më në fund humbet edhe sovranitetin ekonomik.

Në vend që nafta të kthehet në bazë të një industrie kombëtare, ajo mbetet një lëndë e parë që u shërben të tjerëve, ndërsa qytetari shqiptar paguan faturën më të rëndë. Një qeveri që flet çdo ditë për zhvillim duhet të japë përgjigje të qarta: pse nuk u krijua një strategji e vërtetë për përpunimin e naftës? Pse nuk u ngritën politika serioze për rafinim, për industri kimike, për nënprodukte, për plehra kimike, për lubrifikantë, për sektorë që do të hapnin vende pune dhe do të rrisnin eksportin me vlerë të shtuar? Pse Shqipëria duhet të mbetet treg konsumator dhe jo vend prodhues? Pse qeveria e sheh zhvillimin vetëm te bregdeti, te resorti dhe te fotografa, por jo te fabrika, teknologjia, laboratorit dhe uzina? Ministri i Jashtëm premtoi strategji të reja dhe koordinim institucional për periudhën 2026–2030, ndihmë për gjuhën shqipe dhe bashkëpunim me diasporën.

Por pyetja mbetet po aq e fortë: sa herë është takuar realisht shteti me diasporën jashtë protokollit dhe jashtë podiumeve? Sa projekte të prekshme janë mbështetur? Sa qendra kulturore janë hapur? Sa konsullata janë shtuar në vendet ku diaspora shqiptare është masive? Pse në Michigan, ku jeton një numër i madh shqiptarësh, nuk ka një prani konsullore që t’i përgjigjet realitetit të komunitetit? Të mos harrojmë: shqiptarët e diasporës e kanë ndërtuar prej kohësh Shqipërinë natyrore. Ata kanë ruajtur gjuhën,

SAMITI I DIASPORËS, NJË SKENË PA AKTORË

kanë hapur shkolla, kanë financuar aktivitete, kanë mbrojtur çështjen kombëtare, kanë lobuar në Perëndim dhe kanë ndërtuar ura që shpesh shteti nuk ka ditur as t’i konceptojë.

E megjithatë, politika shtetërore ndaj tyre mbetet e fragmentuar, ceremoniale, thuajse dekorative. Lobimi shtetëror nuk koordinohet seriozisht me shoqatat e diasporës, me organizata historike si “Vatra”, e vërteta e diasporës nuk është podkasti i Ramës. Cilat janë politikat e koordinimit të lobizmit qeveritar me lobizmin e shoqatave të tilla si “Vatra”, apo Liga Qytetare Shqiptaro-Amerikane, apo AAF, apo AARC, Këshilli Për Marrëdhëniet Shqiptaro-Amerikane, shoqata që njihen e bashkëpunojnë me Kongresin Amerikan. Sa biznesmenë dhe intelektualë të rinj e të vjetër ka diaspora shqiptaro-amerikane veç Mark Gjonajt, emrit i të cilit në katër vite sollti vetëm një ish-kryetar bashkie të Nju Jorkut, Adams, që pasi humbi zgjedhjet, e natyralizuan shqiptar.

Pse ky samit nuk është ndërtuar për të nxjerrë në pah vlerat reale të diasporës, ata njerëz që për 25 vjet me radhë punojnë për kombin, për gjuhën, për kulturën dhe për imazhin e Shqipërisë jashtë vendit? Pse duket se çdo gjë organizohet për të shtuar duartrokitjet për një skenar të parapërgatitur dhe jo për të dëgjuar realisht ata që kanë diçka për të thënë? Por ky skenar i bukur u përplas me realitetin. Dhe jo nga opozita politike, por nga vetë diaspora. Në një nga panelet, juristja shqiptare që punon në Prokurorinë e Bolonjës, Eva Baçi, bëri atë që rrallë ndodh në këto samite: e prishi

regjinë. “Jeni larg realitetit!” ishte akuza e saj e drejtpërdrejtë ndaj politikës.

Ky nuk ishte një reagim emocional, por një akt akuze i strukturuar ndaj një sistemi që, sipas saj, e përdor diasporën si dekor, por nuk e përfshin si aktor. Ajo e tha qartë: diaspora nuk vjen në samite për të mbushur karriget. Diaspora nuk është numër. Diaspora kërkon të dëgjohet. Dhe, megjithatë, paradoksi më i madh ishte se vetë zëri kritik nuk gjeti hapësirën që meritonte.

Baçi përdori një metaforë të fortë: “Skenari është shkruar shumë bukur, por mungojnë aktorët kryesorë”. Kjo është ndoshta diagnoza më e saktë e marrëdhënies mes shtetit dhe diasporës. Sepse shteti shqiptar ka ndërtuar një narrativë të bukur për diasporën: një komunitet global i suksesshëm, një burim investimesh, një urë mes Shqipërisë dhe botës. Por mungon pjesëmarrja reale. Diaspora trajtohet si objekt i politikave, jo si subjekt i tyre.

Dhe ndërsa në sallë flitet për investime dhe rikthim, jashtë sallës realiteti flet ndryshe. Një investitor përballet me pasiguri ligjore, prona mbetet konfliktuale, projektet shpallen si fitore para se të provojnë funksionalitetin e tyre, ndërsa klima e përgjithshme për biznesin vazhdon të prodhojë mosbesim. Si mund t’i kërkosh diasporës të investojë në një vend ku prona nuk është gjithmonë e sigurt, ku rregullat duken të paqëndrueshme dhe ku shteti shpesh perceptohet jo si garant, por si burim pasigurie? Në këtë kuptim, pyetja e Eva Baçit ishte shumë më e madhe

sesa rasti i saj personal. Ajo përfaqësonte një brez profesionistësh që nuk kërkojnë lëmshë, por hapësirë, nuk kërkojnë privilegj, por meritë, nuk kërkojnë dekoratë, por mundësi reale. “Shqipërisë nuk i mungon truri. I keni mbyllur dyert”. Kjo është fjalja që përmbledh gjithë dramën e samitit. Një nga kritikantët më të forta të saj ishte se diaspora trajtohet si statistikë. Dhe kjo dhemb pikërisht sepse është e vërtetë. Një e treta e kombit jeton jashtë, por në shumë raste kjo fuqi njerëzore, intelektuale dhe ekonomike përmbledhet në shifra, në duartrokitje dhe në dekor patriotik.

Njerëzit që mbajnë familje, biznese, shkolla, media, aktivitete kulturore dhe rrjete lobimi mbeten shpesh pa zë, pa emër dhe pa përfaqësim. Edhe kjo është pjesë e problemit ekonomik që ngritem më sipër. Sepse një shtet që nuk di të përfshijë diasporën në strategji zhvillimi, nuk di as ta ndërtojë zhvillimin. Diaspora nuk mund të thirret vetëm për të blerë apartamente, për të hapur një bujtinë a për të investuar në ndonjë resort. Ajo duhet të ftohet të marrë pjesë në projekte të mëdha kombëtare: në industri, në energji, në teknologji, në përpunim, në universitete, në kërkim shkencor, në diplomaci ekonomike. Vetëm atëherë bashkëpunimi bëhet strategjik dhe jo folklorik. Vlerat e vërteta të diasporës nuk janë vetëm remitancat. Janë sakrificat, profesionalizmi, përkushtimi për identitetin, dëshira për të kontribuar dhe aftësia për të sjellë kulturë pune, dije dhe standarde. Kur Eva Baçi thotë se punon 14 orë në Itali dhe mund të punojë 20 orë për Shqipërinë, ajo nuk bën retorikë. Ajo shpall potencialin e një Shqipërie tjetër, që ende nuk po ndërtohet. Ky pamflet, pra, nuk është thjesht kritikë ndaj një samiti.

Është kritikë ndaj një modeli. Nga njëra anë kemi një shtet që flet për diasporën si shpresë; nga ana tjetër kemi një diasporë që kërkon vetëm të dëgjohet. Nga njëra anë kemi një qeveri që e quan zhvillim ngritjen e kullave, asfaltin, resortin dhe reklamën; nga ana tjetër kemi pyetjen themelore që mbetet pa përgjigje: pse Shqipëria nuk ndërton industri? Pse nuk e përpunon pasurinë e vet? Pse eksporton naftë bruto dhe importon varësi? Pse qytetari shqiptar duhet të paguajë më shtrenjtë për produktet që burojnë nga toka e vet?

Derisa këtyre pyetjeve t’u jepet përgjigje serioze, çdo strategji do të mbetet letër, çdo paketë do të mbetet slogan dhe çdo samit do të mbetet skenë pa aktorë. Sepse diaspora nuk kërkon privilegje. Ajo kërkon drejtësi, hapje, meritë dhe respekt. Dhe pa këto, Shqipëria nuk humbet vetëm investime. Ajo humbet njerëzit e saj më të mirë.

**190 Merton High Street
Wimbledon
London SW19 1AX**



RASHID & RASHID
Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths



Ne mund t'ju ndihmojmë

- **Asylum & Immigration**
- **New Point Based System**
- **Settlement Applications (ILR)**
- **European Law**
- **Nationality & Travel Document**
- **Human Rights Applications**
- **High/Court of Appeals**
- **Over Stayers**
- **Work Premits**
- **Visa Extensions**
- **Judicial Reviews**
- **Tribunal Appeals**



Konsultimet falas

 **07774222062**

 **07878335000**

TEL: 0208 5401 666

TEL: 0208 672 0666

